



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 699 Akti

Nr. 706 Vendimi  
Tiranë, më 20.10.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 18.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Durim Bedini**, me detyrë prokuror në ish-Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, shqyrtoi në seancën dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Durim Bedini, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Durim Bedini ka ushtruar fillimisht detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan në periudhën 1.1.1995 – 1.4.2008, më pas, në periudhën 1.4.2008 – 1.5.2023 ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe aktualisht, nga data 1.5.2023 e në vijim, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.12.2020 dhe do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli (kryesues), Valbona Sanxhaktari (anëtare) dhe Olsi Komici (relator), ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Theo Jacobs.

3. Trupi gjyqësor, me vendimin e datës 15.1.2021, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Durim Bedini për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; rivlerësimi i aftësive profesionale.

4. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike<sup>1</sup>, ku iu komunikua përbërja e trupit gjyqësor dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit. Subjekti<sup>2</sup> deklaroi se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjyqësor.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

6. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

7. Trupi gjyqësor, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 21.1.2021 me anë të postës elektronike, me *email*.

<sup>2</sup> Subjekti i rivlerësimit, po në datën 21.1.2021, njoftoi Komisionin me anë të postës elektronike.

rivlerësimin Durim Bedini, si dhe njoftimin e tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

**8.** Subjekti i rivlerësimin u njoftua në datën 27.9.2023<sup>3</sup> mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 11.10.2023. Subjekti i rivlerësimin, brenda afatit të lënë nga Komisioni, ka dërguar me postë elektronike (*email*) shpjegimet dhe provat përkatëse.

**9.** Subjekti i rivlerësimin në datën 16.10.2023 u ftua në seancën dëgjimore, e cila u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 18.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimin u paraqit personalisht dhe parashtroi shpjegimet e tij dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**10.** Z. Durim Bedini ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimin, duke u përgjigjur kur i është kërkuar sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**11.** Procesi i rivlerësimin, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimin dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**12.** ILDKPKI-ja<sup>4</sup>, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimin Durim Bedini, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. indeksi \*\*\*, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*

<sup>3</sup> Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimin janë bërë me rrugë elektronike, me *email*.

<sup>4</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2017, i ILDKPKI-së.

➤ *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**13.** Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut II të këtij ligji, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**14.** Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacioneve të marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

#### ❖ **Mbi asetet e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting***

##### **Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit**

**1. Apartament me sip. 61 m<sup>2</sup>,** në lagjen “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, h. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Elbasan, ku bashkëjeton me bashkëshorten B. B.

**Burimi i krijimit:** përfituar nga bashkëshortja nga trashëgimia ligjore nga babai i saj N. P. Këtë pasuri prindërit e bashkëshortes e kanë përfituar nga privatizimi i banesave në vitin 1993.

##### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**1.1** Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2003 (në vijim DIPP) subjekti ka deklaruar: “*Shtëpi banimi 2+1 me sip. 84 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, p. \*\*\*. Vlera: 4 milionë lekë. Pjesa takuese: 1/3. Burimi: “Bashkëjetoj në banesën e vjehrrës në pronësi të saj përfituar nga privatizimi”.*

**1.2** Nga analiza e dokumentacionit të depozituar bashkë me deklaratën *Vetting* rezulton se në datën 14.10.1993 është lidhur kontrata për privatizimin e banesës ndërmjet Ndërmarrjes Komonale Banesa Elbasan (në vijim NK Banesa) dhe shtetasit N. P. (babai i bashkëshortes së subjektit) për banesën 2+1, nr. \*\*\*, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, Elbasan. Po në datën 14.10.1993 është lidhur kontrata e shitjes ndërmjet të njëjtave palë për apartamentin e lartpërmendur, kundrejt vlerës 9,160 lekë.

**1.2.1** Pasi i ndjeri N. P. ka ndërruar jetë (në datën 27.5.1994), me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.5.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për trashëgimlënësin N. P., ku si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë përcaktohen bashkëshortja P. P. dhe vajza B. B., të cilat trashëgojnë ½ pjesë secila.

**1.2.2** Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK)<sup>5</sup> konfirmon pronësinë e pasurisë apartament<sup>6</sup> me sip. 61 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi të shtetaseve P. P. (vjehrra e subjektit) dhe B. B.

<sup>5</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Elbasan, drejtuar Komisionit.

<sup>6</sup> Pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

**1.2.3** Furnizuesi i Shërbimit Universal (në vijim FSHU)<sup>7</sup> nuk konfirmon kontrata të energjisë elektrike të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij.

**1.3** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, nga hetimi rezulton se prindërit e bashkëshortes së subjektit e kanë përfituar këtë pasuri kundrejt pagesës 9,160 lekë në datën e lidhjes së kontratës me NK Banesa, 14.10.1993, ndërsa subjekti ka filluar detyrën si prokuror në datën 1.1.1995. Nga vërtetimi<sup>8</sup> i ISSH Drejtoria Rajonale Elbasan rezulton se nëna e bashkëshortes ka përfituar pension prej datës 1.4.1991, ndërsa deri në datën 14.10.1993 ka përfituar të ardhura nga pensioni 12,175 lekë.

**1.4** Rezulton se kjo është pasuri e krijuar nga prindërit e bashkëshortes para marrjes së detyrës si prokuror nga ana e subjektit të rivlerësimit.

✓ **Nuk u konstatuan problematika në lidhje me deklarin dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.**

**2. Apartament banimi me sip. 57.9 m<sup>2</sup>**, në lagjen “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, h. \*\*\*, nr. \*\*\*, Elbasan, i privatizuar bashkë me bashkëshorten në vitin 1993. Ky apartament është shitur në datën 12.5.1997, në vlerën 950,000 lekë.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**2.1** Subjekti i rivlerësimit bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar dokumentacionin e përfitimit të apartamentit me kontratën e privatizimit të datës 27.9.1993 lidhur ndërmjet NK Banesa Elbasan dhe z. Durim Bedini, për çmimin 9,200 lekë. Për këtë apartament më pas u lidh kontrata e shitjes datë 29.9.1993 me të njëjtat palë, për çmimin 10,938 lekë. Me kontratën e datës 12.5.1997 shtetasit Durim dhe B. Bedini ia shesin këtë apartament shtetasit A. R. me çmimin 950,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**2.2** Në pyetësonin standard, subjekti ka deklaruar se në këtë apartament ai ka jetuar së bashku me bashkëshorten deri në datën 12.5.1997. Nga viti 1997 e deri më sot subjekti deklaroi se banon në apartamentin e regjistruar në emër të vjehrrës së tij P. P. dhe bashkëshortes B. B., e cila e ka përfituar nga trashëgimia ligjore e babait të saj N. P..

**2.3** ASHK Elbasan<sup>9</sup> konfirmon pronësinë e subjektit dhe bashkëshortes mbi këtë apartament dhe më pas shitjen e tij për çmimin 950,000 lekë në vitin 1997 blerësit A. R.<sup>10</sup>, duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës.

**2.4** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasin A. R. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>11</sup>.

**2.5** Në lidhje me justifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në shumën 10,938 lekë, në datën 27.9.1993, subjekti ka depozituar në Komision dokumentacionin mbi punësimin e

<sup>7</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021, e FSHU-së, drejtuar Komisionit.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2023, e Drejtorisë Rajonale Elbasan, përcjellë bashkëlidhur pyetësonit nr. 2 dhe vërtetimi i ISSH-së në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. 35.

<sup>9</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021, e ASHK Elbasan, drejtuar Komisionit.

<sup>10</sup> Kontratë datë 12.5.1997, me shitës Durim Bedini dhe blerës A. R., me çmimin 950,000 lekë.

<sup>11</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.9.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, drejtuar Komisionit.

tij dhe të bashkëshortes, si dhe të ardhurat përkatëse<sup>12</sup>, nga ku rezultuan të ardhura të mjaftueshme<sup>13</sup> për blerjen e apartamentit.

**2.6** Komisioni vëren se kjo pasuri është krijuar nga subjekti dhe bashkëshortja para emërimit të subjektit në detyrën e prokurorit dhe se ata kanë pasur mundësi për krijimin e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme.

✓ **Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri.**

**3. Automjet tip “Daimler Chrysler C200, W203”**, vit prodhimi 2002, me targë \*\*\*, blerë datë 23.5.2013, në vlerën 1,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

**Burimi i krijimit:** (a) të ardhurat nga puna; (b) të ardhurat nga shitja e automjeteve të mëparshme, konkretisht:

- janar 2008 blerë automjeti 5,800 euro dhe zhdoganimi 290,000 lekë, me burim nga të ardhurat dhe gjendja cash që dispononte subjekti;
- datë 10.11.2009 blen automjetin në vlerën 1,200,000 lekë, me burim të ardhurat nga puna;
- datë 26.5.2010 blen automjetin në vlerën 125,000 lekë, me burim të ardhurat nga puna;
- datë 26.6.2010 shet automjetin në vlerën 300,000 lekë;
- datë 2.4.2011 shet automjetin në vlerën 10,500 euro;
- datë 23.3.2013 shet automjetin e mësipërm në vlerën 3,000 euro.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**3.1** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë automjet në DIPP-në e vitit 2013 si të blerë në datën 23.5.2013, me vlerë 1,000,000 lekë, me burim të ardhurat e familjes nga puna.

**3.2** Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor<sup>14</sup> (në vijim DPSHTRR) konfirmon automjetin e mësipërm në pronësi të z. Durim Bedini, të përfutur nga kontrata e datës 23.5.2013, me shitës shtetasin S. K.. Ky i fundit, për këtë mjet, në datën 19.5.2013 ka paguar taksën doganore në vlerën 54,356 lekë. Në dosje nuk ndodhet dokumenti i blerjes së këtij automjeti nga shtetasi S. K. në shtetin gjerman, por në dokumentin doganor është vendosur çmimi i referencës 1,500 euro ose 211,050 lekë<sup>15</sup> dhe në total mjeti i ka kushtuar këtij shtetasi 265,406 lekë dhe në datën 23.5.2013 ia shet subjektit me çmimin 1,000,000 lekë.

<sup>12</sup> Me anë të pyetësorit nr. 2 subjekti jep shpjegime për të ardhurat e tij dhe bashkëshortes gjatë viteve, ku sqaron: “Të ardhura nga paga ime që prej vitit 1981 – 1989, hetues në Hetuesinë Elbasan. Prej vitit 1989 – 1991 kam kryer detyrën e kryetarit të Hetuesisë Tepelenë. Për këtë periudhë nuk disponoj dokument në lidhje me të ardhurat nga paga, pasi... nuk ekziston dokument financiar para datës 1.3.1997, pasi janë djegur gjatë trazirave të datës 1.3.1997. Për periudhën 1991 – 1993, kryetar i Hetuesisë Elbasan. Nga viti 1993 – 1995, shef i policisë hetimore në Komisaratin e Policisë Elbasan. Nga viti 1995 – 2005 e në vijim prokuror në Prokurorinë Elbasan dhe Kavajë. Për periudhat 1981 – 1989 dhe 1989 – 1995 nuk disponoj dokument për të ardhurat nga paga, pasi... për këtë periudhë nuk ka listëpagesa të punonjësve të ish-Prokurorisë ku unë kam punuar”. Subjekti përcjell me pyetësorin nr. 2 vërtetimin e Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, datë 24.10.2016 dhe vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 31.7.2023, të Prokurorisë së Rrethit Elbasan, ku konfirmohen shpjegimet e subjektit.

<sup>13</sup> Të ardhurat për 9 muaj 33,047 lekë – shpenzimet jetike (66%) ose 21,811 lekë = 11,236 lekë.

<sup>14</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, e DPSHTRR-së.

<sup>15</sup> Sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, të datës 19.5.2013, ku 1 euro = 140.7 lekë.

**3.3** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi ndërmjet subjektit dhe shitësit S. K., dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>16</sup>.

**Analizë e burimit të krijimit të automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\*, blerë me çmimin 1,000,000 lekë**

**3.4** Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes nga janari 2013 deri në datën e lidhjes së kontratës së blerjes së automjetit, 23.5.2013, nga e cila rezulton se ata kanë pasur mundësi të blejnë automjetin me të ardhura të ligjshme, pasi rezultati i analizës financiare për këtë periudhë është 1,431,128 lekë.

**Tabela nr. 1**

<b>Vitet</b>	<b>1.1.2013 – 23.5.2013</b>
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>3,118,548 lekë</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	481,448 lekë
Të ardhura të bashkëshortes nga aktiviteti i noterisë	902,648 lekë
Të ardhura nga pensioni i nënës së bashkëshortes	75,277 lekë
Të ardhura nga shitja e automjetit me targë ***, në datën 23.3.2013, në vlerën 3,000 euro	420,630 lekë
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Mercedes B180 CDI” me targë ***, në datën 28.2.2013, në vlerën 1,200,000 lekë	1,200,000 lekë
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	38,546 lekë
<b>PASURI</b>	<b>1,024,655 lekë</b>
Ndryshimi i likuiditete në sistemin bankar	- 38,968 lekë
Automjet tip “Mercedes A180 CDI” i vitit 2006, me targë ***, blerë në Gjermani në datën 6.3.2013	1,063,623 lekë
<b>SHPENZIMET</b>	<b>662,765 lekë</b>
Shpenzime udhëtimi	42,063 lekë
Shpenzime jetike për 3 anëtarë	176,280 lekë
Shpenzime të deklaruara në deklaratat periodike	271,505 lekë
Shpenzime mobilimi dhe arredimi deklaruar në pyetësonin nr. 1	172,917 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>1,431,128 lekë</b>

**3.5** Komisioni vëren se edhe pse subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* se për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\* kanë shërbyer edhe të ardhurat nga shitja e automjeteve të mëparshme, të listuara prej tij në deklaram, konstaton se të ardhurat nga puna për vitin 2013 janë të mjaftueshme për blerjen e tij. Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2013, subjekti deklaron si burim të automjetit nga të ardhurat e përbashkëta (në familje) të krijuara nga puna, duke mos deklaruar të ardhurat nga shitja e automjeteve të tjera.

<sup>16</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, drejtuar Komisionit.

**3.6** Sa rezulton më lart nga analiza e Komisionit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshortja kanë pasur mundësi të blejnë me të ardhura të ligjshme të krijuara prej muajit janar 2013 deri në datën e blerjes së tij automjetin me vlerë 1,000,000 lekë.

✓ **Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\*.**

❖ **Komisioni, duke u nisur nga deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* se për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\* kanë shërbyer edhe të ardhurat nga shitja e automjeteve të mëparshme, ka analizuar në vijim edhe automjetet e tjera të deklaruara prej tij.**

**3.7 Automjet tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\***, i vitit 1992, blerë nga Prokuroria e Përgjithshme në vitin 2010, në shumën 125,000 lekë, dhe shitur po në vitin 2010 në vlerën 300,000 lekë.

**3.7.1** Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *“Automjet i blerë në datën 4.6.2010, në vlerën 125,000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat dhe gjendja e të hollave që disponoj cash”*. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *“Shitje e automjetit i llojit “Mercedes-Benz” në vlerën 300,000 lekë”*.

**3.7.2** Nga dokumentacioni<sup>17</sup> i depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë automjet në ankandin e organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme për çmimin 125,000 lekë, paguar në llogarinë bankare të Prokurorisë së Përgjithshme datë 26.5.2010, ndërkohë që ky automjet ishte në përdorim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Më pas, ky automjet, me kontratën e shitblerjes datë 26.6.2010<sup>18</sup>, i shitet shtetasit H. D. për çmimin 300,000 lekë.

**3.7.3** DPSHTRR-ja<sup>19</sup> konfirmon automjetin fillimisht në pronësi të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila me kontratën e datës 4.6.2010<sup>20</sup> ia shet subjektit Durim Bedini me çmimin 125,000 lekë, në bazë të një procedure ankandi. Më pas, subjekti Durim Bedini, në datën 26.6.2010<sup>21</sup>, ia shet këtë automjet shtetasit H. D. me çmimin 300,000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

**3.7.4** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasin H. D. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>22</sup>.

**3.7.5** I pyetur në lidhje me vlerën e shitjes së automjetit, subjekti, në pyetësin nr. 2, shpjegon: *“Automjeti është blerë sipas një procedure specifike, bazuar në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” dhe*

---

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2010, e Prokurorisë së Përgjithshme, ku përcaktohet vlera fillestare e ankandit për automjetin me targë \*\*\*; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2010, njoftim për të drejtën e parablerjes së këtij automjeti nga Durim Bedini, meqë këtë automjet e ka pasur ai në përdorim në Prokurorinë e Rrethit Kavajë; konfirmim pranim oferte, datë 25.5.2010, nga subjekti Durim Bedini; mandatpagesë e Raiffeisen Bank datë 26.5.2010, e shumës 125,000 lekë, paguar nga Durim Bedini; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 26.6.2010.

<sup>18</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 26.6.2010.

<sup>19</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2023, e DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

<sup>20</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.6.2010, me shitës Prokuroria e Përgjithshme dhe blerës Durim Bedini.

<sup>21</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.6.2010, me shitës Durim Bedini dhe blerës H. D.

<sup>22</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.



VKM-në nr. 1242, datë 16.12.2009 “Për rregullat e funksionimit të ankandit...”. Automjeti është shitur nëpërmjet ankandit të zhvilluar nga Prokuroria e Përgjithshme, ku vlera e tij është përcaktuar nga një komision i ngritur për këtë qëllim. Ndërkohë, shitja e automjetit nga ana ime është bërë në treg të lirë sipas çmimit të tregut. Pasi personi që e bleu ra dakord për çmimin, automjeti është shitur nëpërmjet kontratës së shitblerjes me çmimin e shitjes të shënuar në këtë kontratë”.

**3.7.6** Duke iu referuar deklarimit në DIPP-në e vitit 2010 se si burim i blerjes së automjetit kanë shërbyer kursimet e mbajtura *cash*, Komisioni vëren se gjendja *cash* e subjektit të rivlerësimit në dhjetor të vitit 2009 ka qenë 1,611,510 lekë, kjo, pasi bashkëshortja e tij deklaroi në DIPP-në e vitit 2009: “Të padepozituara (*cash*) lekë dhe euro. Vlera: 1,200,000 lekë dhe 3,000 euro”. Kjo gjendje kursimesh *cash* rezultoi e mjaftueshme<sup>23</sup> për të blerë automjetin në vlerën 125,000 lekë. Nga analiza financiare e periudhës 2003 – 2016 rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të krijojë gjendjen *cash* të kursimeve të deklaruara në DIPP-në e vitit 2009, pasi rezultati financiar i vitit 2009 është pozitiv.

**3.7.7** VKM-ja nr. 1242, datë 16.12.2009, përcaktoi shitjen e automjeteve të panevojshme nga ana e institucioneve që i kanë ato në administrim nëpërmjet një procedure ankandi, ku çmimi i automjeteve përcaktohet në një tabelë të hartuar nga zyra doganore, e cila ka përdorur si burim informacioni buletinet që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet evropiane dhe kësaj vlere i zbritet 50% si koeficient amortizimi, për shkak të përdorimit të mjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë<sup>24</sup>, procedurë kjo që të krijojë bindjen se çmimi i automjetit që del në ankand është më i ulët se vlera në tregun e lirë të shitblerjes së automjeteve, duke justifikuar kështu si blerjen e automjetit nga subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe shitjen e mëvonshme të tij me një çmim më të lartë se ai i blerjes.

**Nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme pasurinë e mësipërme.**

**3.8 Automjet tip “Mercedes-Benz E220”, i vitit 2000, me targë \*\*\* (ndryshuar në \*\*\*), blerë në vitin 2009 me çmimin 1,200,000 lekë dhe shitur në vitin 2011 me çmimin 10,500 euro.**

**3.8.1** Subjekti e ka deklaruar këtë automjet për herë të parë në DIPP-në e vitit 2009, blerë në vlerën 1,200,000 lekë, me burim “Të ardhurat dhe gjendja e të hollave që disponoj *cash* (të padepozituara)”, ndërsa në DIPP-në e vitit 2011 deklaroi shitjen e tij në vlerën 10,500 euro.

**3.8.2** Bashkë me pyetësozin standard subjekti ka depozituar kontratën datë 10.11.2009<sup>25</sup>, me të cilën është blerë automjeti nga shtetasi A. L., në vlerën 1,200,000 lekë ose 8,677 euro<sup>26</sup>, likuiduar jashtë zyrës noteriale, ndërsa bashkë me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e datës

<sup>23</sup> Gjendja *cash* e disponueshme në datën 31.12.2009, pas zbritjes së vlerës së blerjes së automjetit me targë \*\*\*, blerë në datën 10.11.2009, në vlerën 1,200,000 lekë, në datën 17.6.2009 është në vlerën 317,530 lekë.

<sup>24</sup> VKM-ja nr. 1242, datë 16.12.2009, kreu IV.

<sup>25</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 10.11.2009, me shitës A. L. dhe blerës Durim Bedini.

<sup>26</sup> Sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, me datë 10.11.2009, ku 1 euro = 138.3 lekë.

2.4.2011<sup>27</sup>, ku subjekti ia shet shtetasit N. D. me çmimin 10,500 euro ose 1,452,150 lekë<sup>28</sup>, paguar jashtë zyrës noteriale.

**3.8.3** Rezulton se subjekti e ka shitur automjetin rreth 1,823 euro ose 252,150 lekë më shtrenjtë nga vlera e blerjes, gati 1 vit e gjysmë nga data e blerjes. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhura vetëm sa vlera e blerjes së tij 1,200,000 lekë.

**3.8.4** DPSHTRR-ja<sup>29</sup> konfirmon se ky automjet ka qenë në emër të z. Durim Bedini, të cilin e ka përfituar nga kontrata e shitblerjes datë 10.11.2009<sup>30</sup>, me shitës A. L., për çmimin 1,200,000 lekë. Shtetasi A. L. e kishte blerë këtë automjet në shtetin gjerman sipas kontratës datë 17.6.2009, me çmimin 2,600 euro<sup>31</sup> (340,366 lekë) dhe sipas dokumentit doganor datë 28.6.2009 ka paguar taksën doganore në shumën 303,149 lekë. Në total, automjeti ka kushtuar 643,515 lekë.

**3.8.5** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti të subjektit me shtetasin A. L. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>32</sup>.

**3.8.6** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë rezulton se në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“Nga të ardhurat dhe gjendja e të hollave që disponoj cash (të padepozituara)”*. Nga deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike rezulton se gjendja e kursimeve *cash* në fund të vitit 2008 ka qenë 2,620,390 lekë, pasi bashkëshortja e tij deklaroi në DIPP-në e vitit 2008: *“Para të padepozituara 2,000,000 lekë, 4,000 euro, 1,000 GBP”*. Kjo gjendje kursimesh *cash* rezulton e mjaftueshme<sup>33</sup> për të blerë automjetin në vlerën 1,200,000 lekë.

**Në përfundim të hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi të krijojnë me të ardhura të ligjshme pasurinë e mësipërme. Nuk konstatohen problematika në lidhje me përfitimin e këtij automjeti.**

**3.9 Automjet tip “Mercedes-Benz A170 CDI”, i vitit 2001, me targë \*\*\*, blerë në vitin 2008 në çmimin 5,800 euro + 290,000 lekë dogana dhe shitur në vitin 2013 në vlerën 3,000 euro.**

**3.9.1** Subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar blerjen e këtij automjeti me burim të ardhurat dhe gjendjen në euro që dispononte *cash* (të padepozituara) një vit më parë, ndërsa në DIPP-në e vitit 2013 deklaroi shitjen e tij në vlerën 3,000 euro.

**3.9.2** DPSHTRR-ja<sup>34</sup> konfirmon se ky automjet ka qenë i regjistruar në emër të z. Durim Bedini dhe më pas është tjetërsuar me kontratën e shitjes së datës 23.3.2013<sup>35</sup> në emër të shtetasve S. e E. K., për çmimin 3,000 euro. Nga dokumentacioni i përcjellë Komisionit ka rezultuar se subjekti Durim Bedini e ka blerë këtë automjet nga shoqëria “\*\*\*\*” në Gjermani, në vlerën 5,800 euro ose

<sup>27</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 2.4.2011.

<sup>28</sup> BOA kursi i këmbimit mesatar 2011 euro/lekë = 138.3

<sup>29</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2023, e DPSHTRR-së.

<sup>30</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 10.11.2009, me shitës A. L. dhe blerës Durim Bedini.

<sup>31</sup> Sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, me datë 17.6.2009, ku 1 euro = 130.91 lekë.

<sup>32</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, drejtuar Komisionit.

<sup>33</sup> Gjendja *cash* e disponueshme në datën 31.12.2008, pas zbritjes së vlerës së blerjes së automjetit me targë \*\*\*, me vlerë 5,800 euro dhe zhdoganimi 293,093 lekë, në datën 23.3.2008 është 1,612,839 lekë.

<sup>34</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, e DPSHTRR-së.

<sup>35</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 23.3.2013, me blerës S. K., për çmimin 3,000 euro.

715,140 lekë<sup>36</sup>, sipas faturës së datës 18.2.2008 dhe nga dokumenti doganor i datës 24.2.2008 rezulton që subjekti ka paguar taksa doganore në shumën 293,093 lekë. Në total, automjeti i ka kushtuar subjektit 1,007,522 lekë.

**3.9.3** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasit S. dhe E. K. dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë<sup>37</sup>.

**3.9.4** Komisioni konstaton se gjendja *cash* e deklaruar prej subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në DIPP-në e vitit 2007 është 2,069,890 lekë, e cila rezulton e mjaftueshme për të blerë automjetin e mësipërm me vlerë 1,007,552 lekë.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe deklarimin e saj.**

## **PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN/BASHKËSHORTJA B. B.**

**4. Automjet tip “Mercedes-Benz A180 CDI”, i vitit 2006, me targë \*\*\***, blerë në Gjermani në vlerën 6,300 euro, nga ku 6,050 euro me bankë dhe zhdoganimi 180,300 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: (a) të ardhurat nga puna; (b) shitja e mjetit të mëparshëm.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**4.1** Bashkëshortja e subjektit në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vlerën 6,300 euro, me burim: *“Shitja e mjetit të mëparshëm dhe të ardhurat në familje nga puna”*.

**4.2** DPSHTRR-ja<sup>38</sup> konfirmon automjetin e mësipërm në pronësi të znj. B. B., të blerë tek shoqëria “\*\*\*” në datën 6.3.2013, në shumën 6,300 euro ose 883,323 lekë<sup>39</sup>, sipas faturës përkatëse. Nga dokumenti doganor i datës 11.3.2013, znj. B. B. ka paguar taksën doganore në shumën 180,300 lekë dhe në total automjeti ka kushtuar 1,063,623 lekë.

**4.3** Credins Bank<sup>40</sup> konfirmon se bashkëshortja e subjektit në datën 5.3.2013 ka depozituar *cash* vlerën 6,050 euro, nga të cilat 6,000 euro i janë transferuar brenda ditës përfituesit Ch. H., me përshkrimin “Për blerje automjeti”.

### **Analizë e burimit të krijimit të këtij automjeti nga të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm**

**4.4 Automjet tip “Mercedes-Benz B180 CDI” me targë \*\*\***, i vitit 2005, blerë në datën 22.4.2011, në vlerën 3,700 euro + dogana 440,000 lekë + transporti 1,500 euro. Burimi i krijimit: *“Të ardhurat dhe gjendja që disponoj cash”*.

**4.4.1** Në DIPP-në e vitit 2011, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar blerjen e këtij automjeti<sup>41</sup>, ndërsa në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar shitjen e tij në shumën 1,200,000 lekë.

<sup>36</sup> Llogaritur sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, ku për datën 18.2.2008 1 euro = 123.3 lekë

<sup>37</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

<sup>38</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2023, e DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

<sup>39</sup> Llogaritur sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, ku për datën 6.3.2013 1 euro = 140.11 lekë.

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021, e Credins Bank.

<sup>41</sup> *“Me datë 22.4.2011 blej autoveturë në Gjermani në vlerën 3,700 euro. Burimi i krijimit: nga të ardhurat dhe gjendja që disponoj në cash. Me datë 18.5.2011 vjen nga Gjermania mjeti dhe paguhet dogana në shumën 440,000 lekë. Nga data 22.4.2011 deri më 18.5.2011 janë shpenzuar për transport tokësor dhe ditor të mjetit 1,500 euro”*.

**4.4.2** DPSHTRR-ja<sup>42</sup> konfirmon se ky automjet ka qenë i regjistruar në emër të znj. B. B., të cilin e ka blerë në shtetin gjerman në datën 22.4.2011 nga shoqëria “\*\*\*”, me çmimin 3,700 euro ose 511,747 lekë<sup>43</sup>, sipas faturës së shitjes. Nga dokumenti doganor i datës 18.5.2011 rezulton se znj. B. B. ka paguar taksën doganore në shumën 289,070 lekë + 1,500 euro transporti ose 207,465 lekë dhe, në total, automjeti ka kushtuar 1,008,282 lekë. Bashkëshortja e subjektit deklaroi në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2011 shumën e zhdoganimit të automjetit në vlerën 440,000 lekë, edhe pse në dokumentin doganor të tij të përcjellë nga DPSHTRR-ja rezulton vlera 289,070 lekë. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare vlerën e zhdoganimit të deklaruar nga bashkëshortja e tij prej 440,000 lekësh. Më pas, me kontratën e shitjes datë 28.2.2013<sup>44</sup>, ky automjet i shitet shtetasit A. Q., me çmimin 1,200,000 lekë.

**4.4.3** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasin A. Q.<sup>45</sup> dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**4.4.4** Bashkëshortja e subjektit deklaroi në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për blerjen e automjetit janë të ardhurat dhe gjendja *cash* që dispononte. Në lidhje me gjendjen *cash* të kursimeve në fund të vitit 2010, rezulton të jetë 1,100,000 lekë, pasi në DIPP-në e vitit 2010 deklarohet nga bashkëshortja e tij: “*Lekë të padepozituara (cash) nga të ardhurat e përfituara nga puna ime dhe e bashkëshortit. Vlera: 1,100,000 lekë*”. Ndërsa vlera totale e shpenzuar për blerjen e automjetit prej subjektit ka qenë 1,159,160 lekë<sup>46</sup>.

**4.4.5** Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit dhe bashkëshortes nga janari i vitit 2011 deri në datën e kryerjes së pagesës sipas faturës së shitjes, 22.4.2011, e cila është si vijon:

**Tabela nr. 2**

<b>Periudha</b>	<b>1.1.2011 – 22.4.2011</b>
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>2,287,547 lekë</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	326,927 lekë
Të ardhura të bashkëshortes nga aktiviteti i noterisë	415,683 lekë
Të ardhura nga pensioni i nënës së bashkëshortes	312,789 lekë
Të ardhura nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz E220” me targë ***, në datën 2.4.2011	1,200,000 lekë
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	32,148 lekë
<b>PASURI</b>	<b>37,735 lekë</b>
Ndryshimi i likuiditete në sistemin bankar	37,735 lekë
<b>SHPENZIMET</b>	<b>226,515 lekë</b>
Shpenzime udhëtimi	89,895 lekë
Shpenzime jetike për 3 anëtarë	136,620 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>2,023,297 lekë</b>

<sup>42</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2023, e DPSHTRR-së.

<sup>43</sup> Konvertuar sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, të datës 22.4.2011, ku 1 euro = 138.31 lekë.

<sup>44</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 28.2.2013.

<sup>45</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

<sup>46</sup> (3,700 euro + 1,500 euro) \* 138.3 (kursi i këmbimit) + 440,000 lekë.

**Sa më lart, rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur mundësi të blejë automjetin tip “Mercedes-Benz B180 CDI” me targë \*\*\*, me të ardhura të ligjshme.**

**4.5** Ndërsa, në lidhje me burimin e krijimit të automjetit tip “Mercedes-Benz A180 CDI” me targë \*\*\*, blerë në vlerën 6,300 euro dhe zhdoganimi 180,300 lekë, nga komunikimi me Credins Bank<sup>47</sup> rezultoi se vlera 6,000 euro është transferuar në llogarinë e shitësit në datën 5.3.2013. Gjithashtu rezulton se kontrata e shitjes së automjetit të mëparshëm tip “Mercedes-Benz B180 CDI” me targë \*\*\* (trajtuar më lart) është lidhur në datën 28.2.2013, me vlerë 1,200,000 lekë. Pra, kjo vlerë rezulton e mjaftueshme për të blerë automjetin e ri me vlerë 1,063,623 lekë (6,300 euro + 180,030 lekë).

**Në përfundim të hetimit rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur mundësi të blejë automjetin tip “Mercedes-Benz A180 CDI” me targë \*\*\*, me të ardhura të ligjshme.**

**5. Depozitë në Credins Bank në shumën 65,349.17 euro.** Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna ndër vite së bashku me bashkëshortin.

**5.1** Bashkëshortja e subjektit e deklaroi për herë të parë depozitën në euro në DIPP-në e vitit 2008, si vijon: “*Depozitë në Credins Bank, dega Elbasan, datë 8.5.2008. Datë 10.5.2008, vlera 10,500 euro. Datë 10.7.2008, vlera 18,440 euro. Burimi i krijimit: tërheqje nga Credins Bank e shumave të depozituara e të deklaruara datë 1.5.2008, datë 10.7.2008, vlera 2,250,000 lekë. Gjithashtu kam tërhequr nga Raiffeisen Bank-Elbasan, datë 8.5.2008, vlerën 1,498,140 lekë. Tek E. Bank, burimi i krijimit: nga puna. Vlera: 1,288,100 lekë. Tek ProCredit Bank, interesi vjetor i depozitës, vlera 84,360 lekë*”.

**5.2** *Historiku i llogarisë së depozitës së kursimit:* Credins Bank<sup>48</sup> informon se depozita e kursimit është hapur në datën 8.5.2008 nga depozitimi *cash* i vlerës 10,500 euro nga bashkëshortja e subjektit. Gjithashtu, brenda vitit 2008 janë bërë edhe dy derdhje të tjera<sup>49</sup> *cash* prej saj, duke e çuar shumën e depozitimeve *cash* në total gjatë vitit 2008 në 47,600 euro, ndërsa në vitin 2009<sup>50</sup> është tërhequr shuma 3,000 euro dhe në vitin 2010<sup>51</sup> është tërhequr shuma 6,000 euro. Gjendja e depozitës së kursimit më 31.12.2016 ka qenë 42,349.17 euro. Në datën 23.1.2017, disa ditë përpara dorëzimit të deklaratës *Vetting* datë 27.1.2017, bashkëshortja e subjektit depoziton vlerën 23,000 euro, me përshkrimin “Kursime”. Pas këtij veprimi gjendja e depozitës është 65,349.17 euro, e cila përputhet me deklarin e saj në deklaratën *Vetting*.

**5.3** Në vijim të historikut të depozitës së kursimit, Credins Bank informon se vlera e saj rezulton të mos jetë përdorur deri në fund të vitit 2020. Bashkëshortja e subjektit depoziton në datën 19.5.2020 vlerën 5,000 euro dhe gjendja e depozitës, së bashku me interesat e akumuluar në datën e kthimit të përgjigjes nga institucioni (datë 31.12.2020), është në vlerën 70,417 euro.

<sup>47</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021, e Credins Bank.

<sup>48</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021, e Credins Bank.

<sup>49</sup> Në datën 10.5.2008 ka derdhur shumën 24,800 euro dhe në datën 10.7.2008 ka depozituar shumën 12,300 euro.

<sup>50</sup> Në datën 30.9.2009.

<sup>51</sup> Në datën 12.4.2010.

**5.4** Në lidhje me burimin e krijimit të depozitës në monedhën euro pranë Credins Bank, në deklaratën Vetting bashkëshortja deklaron: “Të ardhurat nga puna ndër vite së bashku me bashkëshortin”.

**5.4.1** Për burimin e krijimit të vlerës 47,600 euro, të depozituar në vitin 2008, Komisioni për analizën financiare është mbështetur në deklarin e kohës, në DIPP-në e vitit 2008, duke qenë më i detajuar<sup>52</sup>, në të cilin deklaron se për krijimin e vlerës së depozitës kanë shërbyer tërheqje të shumave të ndryshme nga llogaritë e saj në bankat e nivelit të dytë.

**5.5** Nga hetimi i llogarive të znj. B. B., si dhe mbështetur në deklarin e saj në DIPP-në e vitit 2008, rezulton se depozita e kursimit është krijuar sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela nr. 3**

Nr.	Depozitimet në llogarinë e kursimit në euro		Vlerat e tërheqjeve nga llogaritë bankare të bashkëshortes		
	Vlera	Data	Përshkrimi	Vlera	Data
1	€ 10,500	8.5.2008	Tërhequr nga depozita pranë Raiffeisen Bank	1,288,100 lekë	8.5.2008
2	€ 24,800	10.5.2008	Tërhequr nga depozitat në lekë pranë Credins Bank	2,250,000 lekë	10.5.2008
3	€ 12,300	10.7.2008		1,498,140 lekë	10.7.2008
	<b>€ 47,600</b>		<b>Totali</b>	<b>5,036,240 lekë ose € 40,884</b>	

**5.5.1** Bashkëshortja e subjektit deklaron në DIPP-në e vitit 2008 si burim shumë 1,498,140 lekë, të tërhequr nga Raiffeisen Bank në datën 8.5.2008 dhe nga E. Bank tërheq vlerën 1,288,100 lekë. Nga komunikimi me Raiffeisen Bank<sup>53</sup> rezulton se në datën 8.5.2008 bashkëshortja e subjektit ka tërhequr nga llogaria e saj e depozitës vlerën 1,288,100 lekë.

**5.5.2** Bashkëshortja e subjektit ka pasaktësi në deklarin në DIPP-në e vitit 2008, pasi vlera e tërhequr nga Raiffeisen Bank nuk është sa deklaruar 1,498,140 lekë, por 1,288,100 lekë (sa vlera e deklaruar nga bashkëshortja se është tërhequr nga E. Bank). Gjithashtu, në lidhje me deklarin e saj se si burim ka shërbyer edhe vlera e interesit vjetor të depozitës prej 84,360 lekësh pranë ProCredit Bank, rezulton se kjo vlerë është në fakt pranë E. Bank dhe ajo rezulton të jetë e papërdorur prej tyre deri më 31.12.2008, por ka qenë gjendje në llogari.

**Në lidhje me burimin e krijimit të vlerave, të cilat janë burim i depozitimeve cash në depozitë (analizë e burimit të burimit)**

**5.6** Nga Raiffeisen Bank<sup>54</sup> rezulton se vlera e tërhequr në datën 8.5.2008 (pika 1 në tabelën e mësipërme) e ka burimin nga vlera 1,200,000 lekë, e cila ka qenë e investuar prej datës 27.7.2005 pranë kësaj banke në bono thesari. Kjo vlerë së bashku me interesat e akumuluar të bonove të

<sup>52</sup> “Depozitë në Credins Bank, dega Elbasan, datë 8.5.2008; datë 10.5.2008, vlera 10,500 euro; datë 10.7.2008, vlera 18,440 euro. Burimi i krijimit: tërheqje nga Credins Bank e shumave të depozituara e të deklaruara datë 1.5.2008, datë 10.7.2008, vlera 2,250,000 lekë. Gjithashtu kam tërhequr nga Raiffeisen Bank-Elbasan, datë 8.5.2008, vlerën 1,498,140 lekë. Tek E. Bank, burimi i krijimit: nga puna. Vlera: 1,288,100 lekë. Tek ProCredit Bank, interesi vjetor i depozitës, vlera 84,360 lekë”.

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2021, e Raiffeisen Bank.

<sup>54</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2021, e Raiffeisen Bank.

thesarit janë mbajtur pas maturimit të tyre si depozitë kursimi deri në datën e tërheqjes së shumës, 8.5.2008, ku vlera e saj ishte 1,288,100 lekë<sup>55</sup>.

**5.6.1** Me pyetësin nr. 2, subjekti sqaron: “*Depozitimi në datën 27.7.2005, në vlerën 1.200.000, lekë në Raiffeisen Bank nga bashkëshortja ime është kryer me kursime të krijuara nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes sime ndër vite...*”. Subjekti në vijim të pyetësit jep sqarime për të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes gjatë periudhës 1985 – 2005. Subjekti dhe bashkëshortja nuk deklarojnë në DIPP-në e viteve 2003 – 2004 shuma kursimesh *cash*. Në vijim, Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit për periudhën 1.1.2005 – 27.7.2005, nga e cila rezultoi se subjekti ka pasur pamundësi në vlerën 514,331 lekë për krijimin e vlerës 1,200,000 lekë.

**5.6.2** Nga Credins Bank<sup>56</sup> rezulton se bashkëshortja e subjektit në datën e depozitimit të dytë (10.5.2008, pika 2 në tabelën e mësipërme) ka tërhequr prej llogarisë së saj të depozitës<sup>57</sup> në lekë vlerën 2,250,000 lekë ose rreth 18,266 euro<sup>58</sup>. Duket se kjo vlerë e tërhequr nga llogaria tjetër e saj pranë Credins Bank ka mbuluar vetëm pjesërisht vlerën e depozituar 24,800 euro, të derdhur në depozitën e kursimit në të njëjtën datë.

**5.6.3** Komisioni, duke u mbështetur në deklarin e bashkëshortes së subjektit në deklaratën *Vetting*<sup>59</sup> për burimin e krijimit të depozitës pranë Credins Bank, konstatoi se vlera e deklaruar e gjendjes *cash* të kursimeve në vitin 2007 është në total 2,443,525 lekë. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar se gjendja e kursimeve *cash* e vitit 2007 ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz A170 CDI” me targë \*\*\*, me vlerë 1,007,552 lekë. Gjendja e kursimeve e mbetur pas vlerës së blerjes së automjetit është 1,435,973 lekë, e cila rezulton e mjaftueshme për të mbuluar vlerën 6,716 euro ose rreth 827,294 lekë<sup>60</sup>, që është diferenca e pambuluar e depozitimit *cash* me tërheqjen nga llogaria e depozitës në lekë të bashkëshortes.

**5.6.4** Duket se subjekti, për krijimin e shumës 24,800 euro të depozituar në datën 10.5.2008 pranë Credins Bank, ka përdorur gjendjen *cash* të kursimeve të disponuar prej tyre, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 dhe depozitën e kursimit në lekë pranë Credins Bank. Ndërsa në lidhje me burimin e krijimit të depozitës në lekë (analiza e burimit të burimit të burimit) rezulton se vlera e tërhequr prej 2,250,000 lekësh është krijuar nga: (a) derdhja në vlerën 1,200,000 lekë në datën 9.5.2008 dhe në vlerën 50,000 lekë në datën 10.5.2008; (b) gjendja e krijuar e llogarisë prej vitit 2006, në shumën 986,076 lekë.

**5.6.5** Komisioni, duke u nisur edhe nga shpjegimet e subjektit, vëren se ai ka deklaruar gjendje *cash* në DIPP-në e vitit 2007, në vlerën totale 2,443,525 lekë<sup>61</sup>, e cila pas zbritjes së vlerës 1,007,552 lekë, e përdorur për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz A170 CDI” me targë \*\*\*,

<sup>55</sup> Vlera e interesave të bonove të thesarit ishte 44,626 lekë neto. Pra, vlera e llogarisë së bashkëshortes në Raiffeisen Bank, në datën 3.4.2006, arrin shumën 1,244,626 lekë, e cila mbyllet si depozitë kursimi deri në datën 8.5.2008. Në këtë datë vlera e depozitës së kursimit, e cila bëhet (së bashku me interesat e akumuluar), tërhiqet *cash* prej bashkëshortes dhe pasi konvertohet në euro depozitohet në llogarinë e depozitës në Credins Bank.

<sup>56</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021, e Credins Bank.

<sup>57</sup> Nga llogaria e depozitës së kursimit me nr. \*\*\*.

<sup>58</sup> Kursi i këmbimit BOA = 123.1825.

<sup>59</sup> Bashkëshortja deklaron: “*Të ardhurat nga puna ndër vite së bashku me bashkëshortin*”.

<sup>60</sup> BOA kursi i këmbimit lekë/euro = 123.1825.

<sup>61</sup> Subjekti deklaron në DIPP-në e vitit 2007: “*Këmbyer 13,000 euro, 3,000 pound, 4500 USD*”, ndërsa në dokumentacionin e përcjellë me DIPP-në e vitit 2007 në ILDKPKI është bashkëlidhur deklaratë e thjeshtë e subjektit, ku deklaron se shumata e këmbyerë janë gjendje *cash* në shtëpi. Për këtë deklarin jep edhe shpjegime të mëtejshme me pyetësin nr. 2.

si dhe pas zbritjes së shumës së depozitimit *cash* në llogarinë e Credins Bank, më 10.5.2008, prej 6,716 euro ose 827,294 lekë<sup>62</sup>, rezulton se vlera e mbetur e kursimeve *cash* nga viti 2007 është 608,680 lekë<sup>63</sup>.

**5.6.6** Komisioni, duke iu referuar deklarimit të burimit të krijimit të depozitës në deklaratën *Vetting*, konsideroi në analizën financiare të burimit të krijimit të saj se kjo gjendje e mbetur e kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti në DIPP-në e vitit 2007 (si më lart vlera 652,532 lekë) ka shërbyer edhe si burim për mbulimin e shumës së depozituar *cash* në datën 10.5.2008, me vlerë 1,250,000 lekë. Pas analizës së mësipërme rezulton se vlera e pambuluar nga shuma 1,250,000 lekë e depozituar në datën 10.5.2008 është 641,320 lekë.

**5.6.7** Për të hetuar mundësinë e kursimit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për vlerën e pambuluar prej 641,320 lekësh, Komisioni hartoi analizën financiare për periudhën janar – 10.5.2008, nga e cila rezultoi se gjendja financiare ka qenë në shumën 1,813,589 lekë. Pra, subjekti ka pasur mundësi të krijojë vlerën e depozituar *cash* në datën 10.5.2008, në vlerën 1,250,000 lekë, pranë Credins Bank.

**5.6.8** Bashkëshortja e subjektit rezulton se ka tërhequr nga llogaria e saj e depozitës së kursimit në Credins Bank<sup>64</sup> me nr. \*\*\*, në datën 10.7.2008, vlerën 1,498,140 lekë (pika 3 në tabelën e mësipërme). Nga historiku i llogarive të saj pranë Credins Bank konstatohet se kjo vlerë është depozituar prej saj në këtë llogari në datën 7.7.2006 me vlerë fillestare 1,420,000 lekë edhe kjo e fundit duket se fillimisht ka qenë e depozituar në llogari tjetër të kursimit të bashkëshortes me nr. \*\*\*.

**5.6.9** Gjithashtu vihet re se në këtë llogari bashkëshortja ka derdhur gjatë vitit 2006 në total vlerën 2,350,000 lekë, nga e cila është tërhequr vlera 1,420,000 lekë në datën 7.7.2006 dhe vlera e mbetur prej 930,000 lekësh është mbajtur si depozitë, ku në datën 10.5.2008 është tërhequr bashkë me interesat e akumuluar prej saj, për t'u konvertuar më tej dhe depozituar në llogarinë e kursimit në euro, trajtuar me depozitimin e dytë, më lart (pika 5.6.2).

**5.6.10** Subjekti u pyet me pyetësonin nr. 2<sup>65</sup> në lidhje me burimin e krijimit të vlerës së depozituar në vitin 2006, që në total është 2,350,000 lekë, për të cilën sqaron: “*Shumat e depozituara gjatë vitit 2006 në Credins Bank janë nga të ardhurat nga paga ime dhe puna e bashkëshortes për vitin 2005 – 2006 dhe shitja e automjetit sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.5.2006, në shumën 400,000 lekë*”.

**5.6.11** Komisioni hartoi analizën financiare të mëposhtme për të hetuar mundësinë për të kursyer nga të ardhurat e vitit 2006 deri në datën e depozitimeve<sup>66</sup>, e cila është si vijon:

- Depozitimi i parë në këtë llogari është bërë në datën 6.1.2006 në vlerën 700,000 lekë. Kjo vlerë nuk rezulton të jetë krijuar nga të ardhurat e ligjshme të periudhës (1.1.2006 – 6.1.2006) dhe

<sup>62</sup> BOA kursi i këmbimit lekë/euro = 123.1825.

<sup>63</sup> Nga vlera e gjendjes së kursimeve *cash* të deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 (2,443,525 lekë) – vlera e blerjes së automjetit me targë \*\*\* (1,007,552 lekë) – vlera e derdhjes *cash* në depozitën e kursimeve në euro pranë Credins Bank, datë 10.5.2008 (827,294 lekë) = 608,680 lekë.

<sup>64</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021, e Credins Bank.

<sup>65</sup> Pyetja nr. 3.

<sup>66</sup> Depozitimet kanë qenë në datën 6.1.2006, në vlerën 700,000 lekë; në datën 28.3.2006, në vlerën 700,000 lekë; në datën 26.6.2006, në vlerën 250,000 lekë; në datën 7.12.2006, në vlerën 700,000 lekë.



subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në DIPP-në e vitit 2005, e cila mund të shërbente si burim për krijimin e saj.

- Gjithashtu, Komisioni hartoi analizën financiare për periudhën janar 2006 – 26.6.2006, për të hetuar mundësinë e kursimit të subjektit për depozitimet deri në këtë datë (26.6.2006), të cilat në total janë në vlerën 1,650,000 lekë<sup>67</sup>, nga ku rezultoi se subjekti ishte në pamundësi në shumën 296,201 lekë për krijimin e kësaj shume.

**Tabela nr. 4**

<b>Periudha</b>	<b>1.1.2006 – 26.6.2006</b>
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>1,552,216 lekë</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	442,119 lekë
Të ardhura të bashkëshortes nga aktiviteti i noterisë	602,027 lekë
Të ardhura nga pensioni i nënës së bashkëshortes	63,444 lekë
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	44,626 lekë
Të ardhura nga shitja e automjetit BMW me targë ***, shitur në vlerën 400,000 lekë, në vitin 2006	400,000 lekë
<b>PASURI</b>	<b>1,618,519 lekë</b>
Ndryshimi i likuiditeteve në sistemin bankar	1,618,519 lekë
<b>SHPENZIMET</b>	<b>229,898 lekë</b>
Shpenzime udhëtimi	65,563 lekë
Shpenzime jetike për 3 anëtarë	164,336 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>- 296,201 lekë</b>

**5.6.12** Në lidhje me depozitimën e kryer në datën 7.12.2006, me vlerë 700,000 lekë, nga analiza financiare e Komisionit (2003 – 2016) rezulton se viti 2006 është me balancë financiare pozitive. Pra, subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi ta krijojnë këtë vlerë me të ardhura të ligjshme.

**5.6.13** Për burimin e krijimit të vlerës 23,000 euro, të depozituar në janar të vitit 2017, konstatohet se në DIPP-në e vitit 2017 subjekti deklaroi: “Në datën 23.1.2017, bashkëshortja ime ka depozituar në emër të saj në Credins Bank shumën 23,000 euro. Të ardhura nga puna e kursimet ndër vite”. Në DIPP-në e vitit 2011, bashkëshortja e subjektit deklaroi: “Të holla në *cash*, të padepozituara, nga puna ime dhe e bashkëshortit. Vlera: 1,700,000 lekë dhe 3,000 euro”. Në pyetësin nr. 2 shpjegon: “...vlera prej 1,700,000 lekësh dhe 3,000 euro, si gjendje *cash* në DIPP-në e vitit 2011, ka qenë gjendja *cash* në shtëpi në dhjetor të vitit 2011. Në vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015 nuk janë deklaruar shtesa dhe pakësime të gjendjes *cash* që prej vitit 2011, pasi kjo gjendje ka vazhduar të qëndrojë e pandryshuar. Në vitin 2016 është deklaruar shuma e shpenzuar në këtë vit dhe është shënuar diferenca në shumën 764,540 lekë, si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të atij viti. Kjo diferencë përbënte edhe shumën *cash* të krijuar në vitin 2016”.

**5.6.14** Në përmbledhje të sa më lart rezulton se gjendja e kursimeve *cash* më 31.12.2016 ka qenë 2,879,440 lekë ose 21,887 euro, pra rreth 1,113 euro më pak se vlera e depozituar në janar të vitit 2017. Po ashtu, duke iu referuar analizës financiare të Komisionit për periudhën 2003 – 2016,

<sup>67</sup> Depozitimet kanë qenë në datën 6.1.2006, në vlerën 700,000 lekë; në datën 28.3.2006, në vlerën 700,000 lekë; në datën 26.6.2006, në vlerën 250,000 lekë; në datën 7.12.2006, në vlerën 700,000 lekë.

rezulton se subjekti ka balancë pozitive për vitin 2016, në vlerën 342,599 lekë ose 2,533 euro, e cila është e mjaftueshme për mbulimin e diferencës nga kursimet *cash* të depozituara në janar të vitit 2017 pranë Credins Bank. Analiza e burimit të vlerës 23,000 euro është e përfshirë në analizën vjetore të vitit 2016, e cila del me vlerë pozitive.

✓ **Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë deklaram të vitit 2017 në llogarinë e depozitës së kursimit.**

**5.6.15** Në përmbledhje të analizës së burimit te depozitës prej 65,349.17 euro rezulton se bashkëshortja dhe subjekti i rivlerësimit kanë pamundësi financiare, si vijon:

**Tabela nr. 5**

Viti	2008	Burimi i burimit	Pamundësia financiare
Derdhja cash në total në dep	5,863,487 lekë ose 47,600 euro		(1,510,532)
Depozita e kursimit në RBAL tërhequr në dt. 08.05.2008	1,288,100 lekë ose 10,457 euro	Vlera e saj është krijuar nga derdhja cash në dt. 27.07.2005 të vlerës 1,200,000 lekë e cila është mbajtur e investuar në këtë bankë duke akumuluar interesat deri në datën e tërheqjes.	(514,331)
Depozita e kursimit pranë Credins bank nr.*** dt.10.05.2008	2,250,000 lekë ose 18,266 euro	1,250,000 lekë derdhur cash në dt.09.05.2008 me burim të ardhurat korrente të vitit deri në datën e gjendja e llogarisë krijuar nga vitit 2006 vlera 986,076 lekë	(996,201)
Depozita e kursimit pranë Credins bank nr.*** dt.10.07.2008	1,498,140 lekë ose 12,162 euro	Depozitim cash në llogarinë e bashkëshortes në vitin 2006	
Derdhja cash në llogari në dt. 10.05.2008 me burim kursimet e vitit 2007.	827,294 lekë ose 6,716 euro	Burimi: gjendja cash e kursimeve e deklaruar në DIPP 2007	

**5.6.16** Komisioni, gjatë hetimit të kësaj pasurie, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur pamundësi financiare në krijimin e vlerës 65,349.17 euro të investuar si depozitë kursimi në shumën 1,510,532 lekë ose 12,263<sup>68</sup> euro.

**Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.**

#### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

**5.6.17** Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, por edhe në prapësime, shpjegon se të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti i noterisë kanë qenë të konsiderueshme, të cilat i krijojnë mundësinë për të kursyer gjendjen *cash*, të cilat nga pakujdesia e tij nuk janë deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2003 – 2006.

**5.6.18** Subjekti shpjegon në prapësime se Komisioni ka pasaktësi në llogaritjen e tij, duke i kaluar barrën e provës për pamundësi financiare në vlerën 1,510,532 lekë, por, ndërkohë, nga analizat financiare të tij rezulton se pamundësia financiare është 810,532 lekë.

<sup>68</sup> Kursi i këmbimit mesatar i vitit 2017, burimi BOA, 132.95.

## Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

**5.6.19** Komisioni, duke u mbështetur në praktikën e tij (në rastet e vendimit të formës së prerë)<sup>69</sup>, si dhe në praktikën e Kolegjit<sup>70</sup> etj. ka rillogaritur të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga ushtrimi i aktivitetit si person fizik i noterisë, duke konsideruar marzhin e fitimit neto prej 80% të xhiros së aktivitetit.

**5.6.20** Pas reflektimit të mësipërm në analizën financiare<sup>71</sup> rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi financiare të krijojnë depozitën e kursimit në vitin 2005, në vlerën 1,200,000 lekë, pranë Raiffeisen Bank. Gjithashtu përmirësohet edhe rezultati financiar i vitit 2005, duke rezultuar me vlerë pozitive nga vlera negative prej 72,281 lekësh, e përcjellë me rezultate hetimi.

**5.6.21** Komisioni rishikoi analizën financiare për periudhën 2003 – 2007 dhe saktësoi vlerën e pamundësisë për bashkëshorten e subjektit për depozitimet e kryera në vitin 2006, të cilat në total ishin në shumën 2,350,000 lekë. Me rezultatet e hetimit iu dërgua barra e provës për këto depozitime në vlerën 996,201 lekë, për shkak të një gabimi material, ndërsa vlera e pamundësisë së rezultuar nga analiza e Komisionit, në fakt është 296,201 lekë. Pasi u konsiderua saktësimi si më lart dhe pasi u përfshinë në analizë shpjegimet e përcjella me prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore rezultoi se pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për krijimin e depozitës së kursimit me vlerë 65,349.17 euro reduktohet vetëm për vlerën -126,201 lekë.

**6. Depozitë në Credins Bank, në shumën 2,318.1 USD.** Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna ndër vite së bashku me bashkëshortin.

**6.1** Bashkëshortja e subjektit e deklaroi për herë të parë depozitën në dollar në DIPP-në e vitit 2008, si vijon: *“Depozitë në Credins Bank, dega Elbasan. Datë 7.1.2008, vlera 1,500 USD. Datë 9.1.2008, vlera 3,000 USD. Burimi i krijimit: nga të ardhurat”*.

**6.2** *Historiku i depozitës së kursimit:* Credins Bank<sup>72</sup> informon se kjo depozitë rezulton të jetë hapur në datën 7.1.2008, nga derdhja *cash* e vlerës 1,500 USD nga bashkëshortja e subjektit. Pas këtij veprimi, në datën 9.1.2008 i është transferuar në këtë llogari vlera 3,000 USD nga znj. B. F. G. dhe vlera e depozitës arrin shumën 4,596.19 USD, bashkë me interesat në datën 31.12.2008. Ndërsa, në datën 10.5.2010 kryhet një tërheqje prej bashkëshortes në vlerën 2,500 USD dhe më pas nuk kryhen më veprime të tjera deri në datën e kthimit të përgjigjes nga institucioni bankar datë 29.3.2021. Ndërkohë, interesat e saj akumulohen në llogari dhe në datën 31.12.2016 vlera e saj është 2,317.77 USD.

**6.3** *Në lidhje me burimin e depozitës:* Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me transfertën e kryer në këtë llogari prej shtetasës B. F. G., për të cilën shpjegon: *“Derdhja e kryer nga bashkëshortja në shumën 1,500 USD është nga të ardhurat nga puna e saj. Transferimi në datën 9.1.2008 i shumës 3,000 USD nga B. G. është kthim i shumës që bashkëshortja ime i ka dhënë hua vajzës së kushërirës së saj në datën 27.12.2007, nëpërmjet derdhjes në llogarinë e*

<sup>69</sup> Vendimi i Komisionit nr. 372, datë 22.4.2021, për subjektin V. P. (A.).

<sup>70</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 20, datë 14.7.2021, për subjektin V. S. (D.); vendimi i Kolegjit nr. 12, datë 6.7.2020, për subjektin P. Gj.

<sup>71</sup> Vlera e të ardhurave të vitit 2005 ndryshon nga 1,204,054 lekë në 1,544,054 lekë.

<sup>72</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2021, e Credins Bank.

*shtetases B. G. të shumës 3,000 USD, sipas mandatit bashkëlidhur. Arsyeja e kësaj huaje ka qenë për shkak të aplikimit të shtetases B. G. për vizë amerikane dhe e ka kthyer huan brenda pak ditësh nëpërmjet transfertës bankare”. Subjekti ka bashkëlidhur me përgjigjet kopje të mandatit të depozitimit të vlerës 3,000 USD në llogarinë e shtetases B. F. G., në datën 27.12.2007, nga znj. B. B..*

**6.3.1** Në lidhje me vlerën 1,500 USD të transferuar *cash* në llogarinë e depozitës së kursimit nga bashkëshortja rezulton se ajo nuk mund ta ketë krijuar këtë vlerë brenda 7 ditëve gjatë janarit të vitit 2008 (periudha 1.1.2008 – 7.1.2008)<sup>73</sup>, por bashkëshortja e subjektit ka deklaruar gjendje kursimesh *cash* në DIPP-në e vitit 2007, specifikisht ka deklaruar 4,500 USD gjendje *cash*, të cilat janë sa vlera e depozituar në total në depozitë.

**6.4** Komisioni, gjatë hetimit të kësaj pasurie, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur pamundësi financiare në krijimin e saj në vlerën 4,500 USD, të investuar si depozitë kursimi, pasi nuk kanë deklaruar si burim gjendjen e kursimeve *cash*.

**Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.**

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**6.5** Subjekti shpjegon me prapësimet dhe gjatë seancës dëgjimore se në lidhje me konstatimin e Komisionit për pamundësi në vlerën 4,500 USD për krijimin e depozitës së kursimeve në dollar, bashkëshortja e tij ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 gjendjen *cash* në vlerën 4,500 USD. Depozitimi në datën 7.1.2008 pranë Credins Bank i shumës 1,500 USD është nga gjendja *cash* e deklaruar. Diferenca prej 3,000 USD, e cila është kaluar në llogarinë e bashkëshortes në datën 9.1.2008 nga kushërira e saj B. G., ka burim të njëjtën shumë të deklaruar *cash* në DIPP-në e vitit 2007. Marrëdhënia e huas ka ndodhur brenda pak ditësh, nga data 27.12.2007 deri më 9.1.2008, dhe në momentin e deklarimit në mars të vitit 2008 kishte përfunduar. Mosdeklarimi i huas në shumën 3,000 USD, por deklarimi i saj si gjendje *cash* është pasaktësi e paqëllimshme, pasi veprimet janë kryer nëpërmjet sistemit bankar dhe nuk ka asnjë diferencë në shumën e deklaruar. Shuma 4,500 USD në llogari ka burim gjendjen *cash* të deklaruar në DIPP-në e vitit 2007.

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**6.6** Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë shteruese dhe ka përfshirë në analizën financiare vlerën e kthyer nga shtetasja B. G. si burim krijimi për depozitën e kursimit prej 3,000 USD pranë Credins Bank dhe është reduktuar gjendja e kursimeve *cash* e vitit në vlerën 1,000 USD, e cila është përdorur si burim për krijimin e depozitës së kursimit.

✓ **Nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarimin e kësaj depozite dhe burimin e krijimit të saj.**

**7. Depozitë në Raiffeisen Bank, datë 19.12.2011, në shumën 1,174,000 lekë, sot 1,281,264.24 lekë.** Burimi i krijimit: puna ndër vite.

<sup>73</sup> Mbështetur në deklaratimet e saj në organet tatimore rezulton se në vitin 2008 xhiroja e deklaruar ka qenë 3,252,950 lekë.

**7.1** Bashkëshortja e subjektit deklaron në DIPP-në e vitit 2011: *“Datë 19.12.2011 depozitohen me afat 1-vjeçar në Raiffeisen Bank sh.a. Vlera: 1,174,000 lekë. Burimi i krijimit: nga të ardhurat e gjendja e të hollave që disponoj në cash”*.

**7.2** Raiffeisen Bank<sup>74</sup> informohet se në datën 19.12.2011 shtetasi S. P. ka transferuar vlerën 1,174,270 lekë në llogarinë e bashkëshortes së subjektit. Kjo vlerë është investuar si depozitë kursimi nga kjo datë dhe gjendja e saj në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka qenë 1,281,264 lekë, ndërsa vazhdon të mbahet si depozitë ku balanca e saj më 31.12.2020 ka qenë 1,278,103 lekë.

**7.3** Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti, me pyetësin nr. 2, sqaron: *“Shtetasi S. P. është xhaxhai i bashkëshortes sime, i cili për arsyet e veta personale i ka kërkuar mbesës së tij B. B. shumën 1.2 milionë lekë në prill të vitit 2011, shumë të cilën ia ka dhënë cash nga të ardhurat nga puna e saj. Këtë shumë ia ka kthyer nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë e saj në Raiffeisen Bank. Ai e ka disponuar këtë shumë në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank, por për shkak të afatit të maturimit nuk i ka tërhequr nga llogaria e tij. Në momentin e maturimit të depozitës ka bërë kthimin e huas... Për shkak se të dhënat në llogarinë e tij pranë Raiffeisen Bank janë të dhëna personale që i jepen vetëm mbajtësit të llogarisë, është objektivisht e pamundur që të sigurohen nga ana ime”*.

**7.4** Prej komunikimit me Raiffeisen Bank<sup>75</sup> rezultoi se shtetasi S. P. ka pasur depozitë kursimi pranë kësaj banke, të çelur prej datës 30.11.2004, e cila në datën e transfertës bankare drejt bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ka qenë në vlerën 1,174,279 lekë. Gjithashtu, duke iu referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes në lidhje me deklaratimet e gjendjes *cash* të kursimeve, rezulton se vlera e deklaruar e gjendjes *cash* më 31.12.2010 ka qenë 1,100,000 lekë, e cila së bashku me vlerën e të ardhurave të deklaruara nga bashkëshortja për vitin 2011 është në total 1,247,049 lekë<sup>76</sup>, që rezulton e mjaftueshme për të krijuar vlerën 1,174,279 lekë, e cila investohet si depozitë kursimi pranë Raiffeisen Bank.

### **Përputhet deklarimi i subjektit me sa rezultuar nga përgjigjja e institucioneve.**

**8. Depozitë pranë shoqërisë së kursim-kreditit “\*\*\*”, Elbasan, në shumën 5,782,076.8 lekë.** Burimi i krijimit: depozituar me transfertë nga ProCredit Bank shuma 5,586,842 lekë nga puna ndër vite.

**8.1** Në DIPP-në e vitit 2007, deklaron: *“ProCredit Bank, vlera 730,000 lekë”*. Në DIPP-në e vitit 2015, bashkëshortja deklaron: *“Në datën 16.12.2015 kam transferuar nga ProCredit Bank Elbasan pranë shoqërisë së kursim-kreditit “\*\*\*” Elbasan në numrin e llogarisë që kanë në BKT, dega Elbasan, shumën e të hollave. Depozita është krijuar nga puna ndër vite dhe deklaruar çdo ndryshim. Vlera: 5,586,842 lekë”*. Ndërsa, në DIPP-në e vitit 2004, subjekti deklaron: *“Depozitë kursimi 350,000 lekë, pjesa takuese 50%, viti i krijimit 2004. ProCredit Bank”*.

**8.2** Nga shkresa e përcjellë nga ProCredit Bank<sup>77</sup> rezulton se bashkëshortja e subjektit ka depozituar *cash* në datën 31.7.2004 vlerat 3,500,000 lekë dhe 500,000 lekë, nga të cilat vetëm

<sup>74</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2021, e Raiffeisen Bank.

<sup>75</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2023, e Raiffeisen Bank.

<sup>76</sup> Subjekti shpjegon se vlera i është dhënë shtetasit S. P. në prill të vitit 2011. Pra, në prill të vitit 2011 vlera e të ardhurave nga aktiviteti është rreth 415,683 lekë.

<sup>77</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, e ProCredit Bank.

3,500,000 lekë investohen në depozitë kursimi. Ndërsa në vitin 2007 (datë 2.8.2007) depozitohet *cash* vlera 728,200 lekë. E gjithë vlera e depozitës prej 5,586,842 lekësh, së bashku me interesat e akumuluar nga data e hapjes së saj, 31.7.2004, janë transferuar në datën 16.12.2015, me përshkrimin “Banka Kombëtare Tregtare, Tirana, shoqëri kursim-krediti “\*\*\*\*”.

**8.3** Shoqëria e kursim-kreditit “\*\*\*\*”<sup>78</sup> konfirmon se shtetasja B. B. ka depozitë kursimi me afat 12-mujor në lekë, vlera e së cilës në datën 27.1.2017 është 5,782,076 lekë. Bashkëlidhet me shkresën kopja e kontratës së depozitës me afat të lidhur në datën 16.12.2015.

**8.4** Në lidhje me burimin e krijimit të depozitës pranë ProCredit Bank rezulton se janë derdhur *cash* në llogari në datën 31.7.2004 vlera 4,000,000 lekë dhe në datën 2.8.2007 vlera 728,200 lekë. Komisioni kërkoi shpjegime për burimin e ligjshëm të këtyre depozitimeve, për të cilat subjekti sqaron: “*Depozitimet në ProCredit Bank në datën 31.5.2004, në shumën 3,500,000 lekë dhe në datën 31.7.2004, në shumën 500,000 lekë, janë krijuar nga kursimet nga të ardhurat nga pagat e mia dhe të bashkëshortes për periudhën 1987 – 1989, kur kemi filluar punë për herë të parë dhe, në vijim, deri në vitin 2004... Shumat prej 700,000 lekësh dhe 28,200 lekësh, të depozituara në datën 2.8.2007, janë nga të ardhurat nga paga dhe puna e bashkëshortes, të vitit 2007*”.

**8.5** Në lidhje me shumën 4,000,000 lekë, të depozituar në datën 31.7.2004, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar gjendje kursimesh *cash* në DIPP-në e viteve 2003 – 2004, e cila mund të shërbente si burim për krijimin e vlerës së depozituar në këtë datë. Pra, sqarimet e subjektit për burimin e krijimit të tyre nuk janë të mbështetura në deklaratimet e kohës.

**8.6** Komisioni hartoi analizën financiare të periudhës 1.1.2004 – 31.7.2004, për krijimin e shumës 4,000,000 lekë dhe analizën për periudhën 1.1.2007 – 2.8.2007, për shumën 728,200 lekë, nga ku u konstatua: (a) pamundësi financiare në krijimin e shumave të depozituara në depozitë kursimi në ProCredit Bank në vitin 2004, në vlerën 3,265,553 lekë; (b) për periudhën janar – 2.8.2007, mundësi financiare për kursimin e vlerës 780,200 lekë deri në datën 2.8.2007, e cila është depozituar në llogarinë e depozitës së saj pranë ProCredit Bank.

**Në lidhje me pamundësinë financiare prej 3,265,553 lekësh, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.**

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**8.7** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se pamundësia financiare në krijimin e depozitës së kursimit ka ardhur për shkak të mosdeklarimit të gjendjeve të kursimeve të mbajtura *cash* në deklaratat e interesave privatë periodikë të viteve 2003 – 2006. Kjo ka qenë pasaktësi e subjektit, e cila vinte pasi nuk ishte kuptuar saktë prej tij detyrimi i deklaratimit të kursimeve *cash*, duke qenë edhe vitet e para të plotësimit të këtyre deklaratave. Subjekti sqaron se mosdeklarimet e gjendjes *cash* gjatë deklaratimeve të para periodike vjetore janë pasaktësi të paqëllimshme, të cilat nuk kanë pasur për qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo deklarimi të rremë lidhur me ligjshmërinë e burimeve të përdorura për krijimin e depozitave

<sup>78</sup> Përcjellë me dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. 36.

bankare, duke shpjeguar dhe kërkuar të mbahet në konsideratë edhe qëndrimi i Kolegjit<sup>79</sup> në lidhje me pasaktësitë në deklaram, të cilat nuk afektojnë burimin e ligjshëm.

**8.8** Gjithashtu, subjekti ka insistuar në faktin se ata kanë pasur mundësi ta krijojnë këtë depozitë me burime të ligjshme financiare, duke e justifikuar me faktin se gjatë gjithë kohës kanë qenë të punësuar me bashkëshorten, duke marrë në konsideratë edhe të ardhurat nga aktiviteti i noterisë të ushtruar prej saj, se nuk ka kryer asnjë investim në pasuri të paluajtshme apo edhe të luajtshme, janë pa fëmijë dhe gjatë gjithë kohës kanë pasur një situatë të shëndoshë financiare, çka reflektohet edhe me balancat financiare pozitive të konsiderueshme, jo vetëm para deklaramit për herë të parë të pasurisë, por edhe në vazhdimësi.

### Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

**8.9** Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me realizimin e kursimeve *cash* prej tij dhe bashkëshortes në periudhën përpara depozitimit të vlerave në ProCredit Bank në vitin 2004 janë të mbështetura edhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni. Nga analiza financiare e hartuar nga Komisioni për periudhën 1995 – 2003 rezulton se subjekti dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi të krijojnë me të ardhura të ligjshme vlerën e kursimeve *cash* prej 3,850,105 lekësh, e cila së bashku me të ardhurat e vitit 2004, si më poshtë rezultuar nga analiza financiare, plotësojnë vlerën e depozituar në ProCredit Bank në vitin 2004, në shumën 4,000,000 lekë.

**Tabela nr. 7**

Periudha	1.1.2004 – 31.7.2004
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>1,355,498 lekë</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	709,361 lekë
Të ardhura të bashkëshortes nga aktiviteti i noterisë	583,333 lekë
Të ardhura nga pensioni i nënës së bashkëshortes	62,804 lekë
<b>SHPENZIMET</b>	<b>336,169 lekë</b>
Shpenzime udhëtimi	76,044 lekë
Shpenzime jetike për 3 anëtarë	109,625 lekë
Shpenzime mobilimi dhe arredimi, deklaruar në pyetësorin nr. 1	150,500 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>1,019,329 lekë</b>

**8.10** Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me pasaktësitë në deklarimin e gjendjeve të kursimeve *cash* në deklaramat periodike të viteve 2003 – 2006 dhe mundësia për krijimin e tyre mbështetet edhe nga analiza e Komisionit. Ky konkluzion përkon edhe në një vlerësim logjik, me argumentet bindëse të dhëna nga subjekti i rivlerësimit se ai dhe bashkëshortja kanë pasur në vazhdimësi një gjendje të shëndoshë financiare e, për rrjedhojë, kanë pasur mundësi të krijojnë këtë depozitë me burime të ligjshme financiare, duke e justifikuar me faktin se gjatë gjithë kohës kanë qenë të punësuar me bashkëshorten, duke marrë në konsideratë

<sup>79</sup> Vendim nr. 29, datë 21.7.2022.

edhe të ardhurat nga aktiviteti i noterisë së ushtruar nga bashkëshortja, se nuk ka kryer asnjë investim në pasuri të paluajtshme apo edhe të luajtshme, janë pa fëmijë dhe gjatë gjithë kohës kanë pasur një situatë të shëndoshë financiare, çka reflektohet edhe me balancat financiare pozitive të konsiderueshme, jo vetëm para deklarimit për herë të parë të pasurisë, por edhe në vazhdimësi. Në vijim, Komisioni vlerëson duke u mbështetur në praktikën e konsoliduar edhe të Kolegjit<sup>80</sup> se pasaktësitë në deklarime periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

**8.11** Në vijim të analizës të mësipërme, Komisioni vlerësoi se rezultati financiar i vitit 2003, i cili rezulton në analizën financiare në vlerën 1,599,890 lekë, duhet të përfshihet si gjendje likuiditeti *cash* dhe si burim krijimi për depozitën e kursimit në vlerën 4,000,000 lekë në ProCredit Bank, në vitin 2004.

**8.12** Komisioni vlerëson se ka një lidhje logjike, ekonomike dhe ligjore që të krijojnë bindjen se burimi i krijimit të depozitës prej 4,000,000 lekësh në vitin 2004 janë pikërisht kursimet e vitit 2003, për arsye se:

- a) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar si burim të ardhurat nga puna ndër vite, kursimet nga të ardhurat nga paga, deklarim që detyrimisht lidhet me balancën financiare dhe mundësinë për kursim të vitit 2003.
- b) Është plotësisht e pamundur dhe pa logjikë financiare që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur të kenë mundësuar kursimin e një shume prej 4,000,000 lekësh vetëm me të ardhurat për periudhën 1.1.2004 – 31.7.2004, çka përsëri do të thotë që burimi i krijimit lidhet me mundësinë financiare për kursim në vitin 2003.
- c) Referuar analizës financiare të vitit 2003 konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur mundësi për kursim deri në datën 31.12.2003, në shumën 1,599,890 lekë, shumë kjo më se e mjaftueshme për t'u investuar në depozitën prej 4,000,000 lekësh në datën 31.7.2004.
- d) Komisioni, në vijim të kësaj linje logjike, mban parasysh edhe qëndrimin e Kolegjit<sup>81</sup>, në bazë të të cilit ka konkluduar se për sa kohë pavarësisht pasaktësisë në deklarimin e vitit 2003 (mosdeklarimi i gjendjes *cash* 1,599,890 lekë) nga analiza financiare e vitit 2003 e kryer nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një tepriçë pozitive në këtë vit në vlerën 1,599,890 lekë, që mbulon krijimin e shumës së depozitës në llogari bankare në janar të vitit 2004.

**8.13 Në konkludim**, pas përfshirjes së rezultatit të vitit 2003 si burim për krijimin e vlerës 4,000,000 lekë në krijimin e depozitës së kursimit pranë ProCredit Bank, pamundësia e subjektit

---

<sup>80</sup> Vendim nr. 37, datë 24.11.2021: "Pavarësisht deklarimeve jo të plota të subjektit në vitet 2003 - 2004 për pasurinë likuiditet, nga leximi dhe analiza logjike e deklarimeve të bëra prej tij qoftë në DPV-në e vitit 2004, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në çdo rast, subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij edhe në version e pranuar prej Komisionerit Publik se ai zotëron me bashkëshorten të gjithë shumën. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi".

<sup>81</sup> Vendim i Kolegjit nr. 33/2021, të subjektit të rivlerësimit N. T.



të rivlerësimit për krijimin e saj është në vlerën 1,380,781 lekë. Krahasuar me peshën që zë kjo balancë financiare negative në raport me vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit, Komisioni mban në konsideratë si një rrethanë që shkon në favor të subjektit të rivlerësimit edhe faktin se për periudhën para deklarimit për herë të parë të pasurisë, deri më 31.12.2002, subjekti i rivlerësimit rezulton me një situatë të kënaqshme financiare, që reflektohet në një balancë financiare pozitive prej 2,250,215 lekësh, e cila shtohet edhe më shumë në vitet pasardhëse.

**9. Bashkëshortja B. B., notere në Elbasan, regjistruar si person fizik në organet tatimore në datën 18.2.2002, me NIPT \*\*\*.** Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin periudha 2005, 2006, 2014, 2015, 2016 dhe tatimi mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël periudha 2008 – 2013. **Të ardhura në shumën neto: 18,022,246 lekë.**

**9.1** Bashkëshortja e subjektit deklaron në deklaratat periodike të viteve 2003 – 2016 të ardhura nga aktiviteti si notere, në vlerën totale neto 14,066,816 lekë.

**9.2** Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim QKB)<sup>82</sup> konfirmon personin fizik “B. B.” me NIPT \*\*\*, me aktivitet “Notere”, regjistruar në datën 12.8.2002. Gjithashtu, nga organet tatimore konfirmohet se subjekti është regjistruar pranë organeve tatimore<sup>83</sup> në datën 18.2.2003 dhe qarkullimi i deklaruar, detyrimet tatimore dhe fitimi i deklaruar për periudhën 2003 – 2016 kanë qenë si në tabelën e mëposhtme.

**9.3** Ndërsa, me pyetësin nr. 2<sup>84</sup>, subjekti shpjegon: *“Për vitet 2003 – 2004 dhe në vijim bashkëshortja ime ka ushtruar funksionin e noteres, ku për vitet 2003 – 2004 ka pasur xhiro të deklaruar në shumën 1.5 milionë lekë për çdo vit, duke paguar tatim fiks dhe taksa vendore në shumën 90,000 lekë. Duke zbritur shpenzime për qira, kancelari etj., fitimi neto i realizuar ka qenë në shumën rreth 1 milion lekë për çdo vit (2003 – 2004 = 2 milionë lekë). Për vitin 2005, për shkak të kualifikimit si biznes i vogël, tatimet janë paguar sipas xhiros 2 milionë lekë në vit. Fitimi i realizuar, duke zbritur detyrimet dhe shpenzimet, ka qenë rreth 1.5 milionë lekë”.*

**9.4** Në vijim të sa më sipër rezultuar nga hetimi, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shumat e paraqitura në tabelën e mëposhtme, duke u mbështetur në praktikën e tij për vitet, të cilët kanë vetëm deklarim të qarkullimit dhe jo të fitimit. Komisioni ka llogaritur në këtë fazë të hetimit marzhin e fitimit për këto vite, 2003 – 2007, si mesatare e marzheve të fitimit të viteve pasardhëse, e cila rezulton të jetë 63%. Ndërsa, në rastet kur bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratat vjetore vlerë më të ulët fitimi se ajo çfarë rezulton nga përgjigjet e institucioneve, në analizën e Komisionit janë përfshirë këto të ardhura të deklaruara prej saj.

---

<sup>82</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021, e QKB-së.

<sup>83</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, e DPT-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, e DTR-së Elbasan; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2017, e Bashkisë Elbasan, në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. \*\*\*; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2017, e DTR-së Elbasan, në dosjen e ILDKPKI-së, aneks nr. 33; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2023, e DTR-së Elbasan, përcjellë me pyetësin nr. 2.

<sup>84</sup> Pyetjet nr. 10 dhe nr. 1.

**Tabela nr. 8**

Viti	Qarkullimi i deklaruar	Fitimi neto sipas deklarimeve të subjektit	Fitimi neto sipas deklarimeve në tatime dhe nga llogaritja e komisionit	Fitimi neto i përfshirë në analizën e komisionit
2003	1,500,000 Lekë	1,000,000 Lekë	855,000 Lekë	855,000 Lekë
2004	1,500,000 Lekë	1,000,000 Lekë	855,000 Lekë	855,000 Lekë
2005	2,000,000 Lekë	*	1,204,054 Lekë	1,204,054 Lekë
2006	3,500,000 Lekë	*	2,152,500 Lekë	2,152,500 Lekë
2007	3,500,000 Lekë	*	2,152,644 Lekë	2,152,644 Lekë
2008	3,252,950 Lekë	*	2,431,289 Lekë	2,431,289 Lekë
2009	2,810,500 Lekë	*	1,721,646 Lekë	1,721,646 Lekë
2010	2,201,304 Lekë	992,263 Lekë	1,257,903 Lekë	992,263 Lekë
2011	2,110,458 Lekë	1,366,570 Lekë	1,247,049 Lekë	1,247,049 Lekë
2012	2,097,593 Lekë	1,286,765 Lekë	1,220,387 Lekë	1,220,387 Lekë
2013	3,184,449 Lekë	2,348,171 Lekë	2,166,354 Lekë	2,166,354 Lekë
2014	3,630,101 Lekë	2,920,170 Lekë	2,702,157 Lekë	2,702,157 Lekë
2015	4,011,797 Lekë	3,269,587 Lekë	3,024,368 Lekë	3,024,368 Lekë
2016	2,504,033 Lekë	883,290 Lekë	886,090 Lekë	883,290 Lekë
<b>Totali</b>		<b>15,066,816 Lekë</b>	<b>23,876,441 Lekë</b>	<b>23,608,001 Lekë</b>

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

**9.5** Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, por edhe me prapësime, shpjegon se të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti i noterisë kanë qenë të konsiderueshme dhe jo sa llogaritur nga Komisioni, të përcjella me rezultatet e hetimit, të cilat i krijojnë mundësinë për të kursyer gjendje *cash*, që nga pakujdesia e tij nuk janë deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2003 – 2006.

### Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

**9.6** Komisioni, duke u mbështetur në praktikën e tij dhe të Kolegjit, të referuara në pikën 5.6.19 si më lart, ka rillogaritur të ardhurat e bashkëshortes së subjektit për periudhën 2003 – 2007, në të cilën nuk përcillet informacion nga tatimet për fitimin e realizuar prej saj, duke konsideruar marzhin e fitimit neto 80% të xhiros. Si pasojë e rillogaritjes, të ardhurat totale nga noteria për periudhën 2003 – 2016, e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, janë 25,428,001 lekë, vlerë e cila është përfshirë në analizën financiare të Komisionit.

### KONSTATIME TË TJERA

**10. Automjet tip “BMW”, me targë \*\*\*, përfitur me dhurim në vitin 2001 dhe shitur në vlerën 400,000 lekë, në vitin 2006**

#### Hetimi i kryer nga Komisioni

**10.1** Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar: *“Makinë tip “BMW” me targë \*\*\*, me vlerë 400,000 lekë, me burim dhuruar nga A. L., banues në Fier”*, ndërsa në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar: *“Shitur automjeti tip “BMW”, në vlerën 400,000 lekë, kontrata nr. \*\*\*”*.

**10.2** Në pyetësin standard, subjekti ka shpjeguar se shtetasi A. Z. është kushëri i bashkëshortes së tij, që në atë kohë jetonte në Itali dhe në kohën kur vinte në Shqipëri rrinte tek shtëpia ku banonte subjekti, pasi të afërmit ndodheshin në SHBA. Në shenjë falënderimi, mjetin donte ta dhuronte dhe jo ta shiste, duke bërë kontratën e dhurimit.

**10.3** Subjektit, me anë të pyetësorit nr. 2, i është kërkuar të shpjegojë mospërputhjen e emrit të këtij shtetasi, pasi subjekti deklaroi A. Z., ndërsa në kontratën e dhurimit rezultoi emri A. L. Gjithashtu, subjekti iu kërkuar që të provojë edhe burimin e ligjshëm të dhuruesit të automjetit për vlerën e blerjes prej tij.

**10.3.1** Subjekti ka shpjeguar se: *“A. L. është djali i tezes së bashkëshortes sime. Emri i tij është A. Z.. Mospërputhjet në të dhënat mund të jenë pakujdesi e noterit gjatë hartimit të kontratës së dhurimit. Prej shumë vitesh ai ndodhet në USA bashkë me familjen dhe është në pamundësi për të siguruar dokumentacion në lidhje me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen prej tij të këtij automjeti që në vitin 2001, kohë në të cilën ai jetonte në Itali”.*

**10.3.2** Subjekti i bashkëlidh përgjigjeve të tij edhe certifikatat nga zyra e gjendjes civile, ku informon se shtetasi A. Z. është djali i motrës së bashkëshortes.

**10.4** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasin A. L./A. Z. dhe nga hetimi<sup>85</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**10.5** Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja<sup>86</sup> rezultoi se ky automjet ka qenë në pronësi të subjektit Durim Bedini, i cili e ka përfituar me kontratën e dhurimit datë 31.8.2001<sup>87</sup>, dhuruar nga shtetasi A. L.. Sipas dokumentit doganor datë 22.8.2001 rezultoi emri A. L., që ka paguar taksën doganore në vlerën 136,405 lekë, ku pasqyrohet edhe vlera e mjetit prej 230,000 lekësh. Në total, automjeti ka kushtuar 366,405 lekë. Më pas, me kontratën e datës 26.5.2006, subjekti Durim Bedini ia shet automjetin tip “BMW”, i vitit 1988, shtetasit A. Ç. ( i biri i N., i datëlindjes 29.10.1962), me çmimin 400,000 lekë, likuiduar *cash*.

**10.6** Konstatohet se nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja në kontratën e dhurimit rezultoi pala dhuruese A. L., me atësi A., i datëlindjes 1975 dhe nënshkrimi në fund të kontratës së dhurimit është gjithashtu i nënshkruar me emrin A. L.. Leja e qarkullimit italiane është me emrin A. L., i lindur në Gjirokastrë, i datëlindjes 6.2.1975.

**10.6.1** Subjekti deklaroi se nuk është shtetasi A. L., por A. Z.. Deklarimi i subjektit se emri A. L. është gabim i noterit kur ka hartuar kontratën e dhurimit është kontradiktor, me të dhënat e shënuara në kontratën e dhurimit për këtë shtetas, A. A. L., i datëlindjes 1975, ndërkohë që subjekti deklaroi se është shtetasi A. P. Z., i datëlindjes 26.7.1974.

**10.7** Komisioni, gjithashtu, në kuadër të heqjes së çdo dyshimi për përfshirje të shtetasit A. A. L., i datëlindjes 1975, apo A. P. Z., i datëlindjes 26.7.1974, në veprimtari të kundërligjshme, ka kryer hetime të mëtejshme, si vijon:

i) Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar<sup>88</sup> konfirmon se ndaj shtetasve A. L. dhe A. Z. nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

<sup>85</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.9.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, dhe përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.9.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, drejtuar Komisionit.

<sup>86</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, e DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

<sup>87</sup> Kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 21.8.2001, me dhurues A. L..

<sup>88</sup> Përgjigja e PPKKKO-së nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2023, drejtuar Komisionit.

ii) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar<sup>89</sup> konfirmon se nuk rezultojn të ketë vendime penale dhe nuk ka aktualisht dosje penale në gjykim në ngarkim të shtetasve A. L. dhe A. Z..

**10.8** Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramë kontradiktore në lidhje me identitetin e dhuruesit të automjetit tip “BMW”, si vijon:

i) Në pyetësorin standard dhe në pyetësorin nr. 2 subjekti deklaroi se bëhet fjalë për shtetasin A. Z., ku sipas certifikatës së depozituar ka atësi P., i datëlindjes 26.7.1974.

ii) Kontrata e dhurimit e depozituar nga subjekti ka të dhënat A. A. L., i datëlindjes 1975, e nënshkruar po me këtë emër, nënshkruar gjithashtu edhe nga subjekti Durim Bedini.

iii) Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja rezultojn shtetasi A. L., i datëlindjes 6.2.1975.

iv) Për burimin e krijimit, subjekti nuk arriti të provonte burimin e krijimit të automjetit të mësipërm të blerë nga shtetasi A. L. (Z.), sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, burimi i krijimit të automjetit rezultoi me pamundësi financiare, në total në vlerën 366,405 lekë.

**Për konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.**

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**10.9** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar: *“ Në cilësinë e pranuesit të dhurimit, në kushtet kur ai ishte familjar, i njohur personalisht, një person pa asnjë precedent penal apo në konflikt interesi, nuk i kam kushtuar rëndësi të dhënave të identitetit në kontratën e dhurimit, pasi nuk kisha asnjë dyshim për identitetin e tij. Mospërputhjet në dokumente nuk kanë ardhur si pasojë e veprimeve të mia ”.*

**10.10** Për burimin e krijimit të pasurisë nga dhuruesi, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar: *“ Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie në vlerën e tij prej 366,405 lekësh, sqaroj se, ashtu siç e kam shpjeguar edhe në pyetësorin e mëparshëm, jam në pamundësi për të depozituar dokumentacion në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë nga dhuruesi, për shkak të kohës tepër të gjatë që ka kaluar nga dhurimi (2001) dhe faktit se ai jeton prej shumë vitesh në USA. Në kohën kur ai është bërë pronar i automjetit ka jetuar dhe punuar në Itali, fakt që konfirmohet edhe nga dokumentacioni i origjinës së këtij mjeti. Kjo e bën të pamundur që unë të siguroj personalisht dokumente të punësimit të tij në shtetin italian ”.*

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**10.11** Komisioni i ka vlerësuar të mjaftueshme shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me identitetin e personit që i ka dhuruar automjetin tip “BMW”. Ai ka pranuar se është treguar i pakujdesshëm në lidhje me të dhënat personale të deklaruara për shtetasin A. Z., pasi nuk ka pasur dyshim për identitetin e tij. Ai gjithashtu ka shpjeguar se ky person nuk ka pasur asnjëherë precedent penal dhe nuk ka pasur konflikt interesi. Komisioni vlerëson se pas verifikimeve të

<sup>89</sup> Përgjigja e GJPSHPKKP-së nr. \*\*\* prot., datë 12.9.2023, drejtuar Komisionit.

kryera nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur çështje në hetim në prokuroritë ku ai ka ushtruar detyrën e prokurorit me shtetasin A. L. apo A. Z.. Gjithashtu, edhe nga verifikimi në Prokurorinë dhe Gjykatën e Posaçme nuk ka rezultuar që dy shtetasit të kenë pasur çështje penale për vepra që lidhen me trafikimet apo grupet kriminale.

**10.12** Në lidhje me burimin me të cilin dhuruesi kishte blerë automjetin, Komisioni i konsideron të mjaftueshme dhe bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke vlerësuar se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për t'i siguruar Komisionit dokumentacionin e të ardhurave të realizuara në Itali nga shtetasi A. Z., ashtu siç parashikon pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

**Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika në lidhje me automjetin tip “BMW”, dhuruar subjektit të rivlerësimit nga shtetasi A. Z.**

## **11. Kursime *cash* të deklaruara nga subjekti dhe bashkëshortja e tij në deklaratat periodike të pasurive**

**11.1** Subjekti nuk deklaron gjendje kursimesh *cash* në deklaratën *Vetting*. Ndërsa gjatë deklaratave periodike të viteve 2007 – 2011 ai dhe bashkëshortja deklarojnë si më poshtë:

- i) Subjekti deklaron në DIPP-në e viteve 2007: “*Këmbyer vlera 13,000 euro, 3,000 pound dhe 4500 USD*”, ndërsa në dokumentacionin e përcjellë me deklaratën e vitit 2007 pranë ILDKPKI-së ka dorëzuar edhe deklaratë të thjeshtë, ku shpjegon se shuma (valuta) e këmbyer nuk është depozituar në bankë, por është gjendje në banesë.
- ii) Bashkëshortja e subjektit deklaron gjendje kursimesh *cash* në banesë në DIPP-në e viteve 2008 – 2010:
  - në DIPP-në e vitit 2008: “*Para të padepozituara 2,000,000 lekë, 4,000 euro, 1,000 pound*”;
  - në DIPP-në e vitit 2009: “*Të padepozituara cash lekë dhe euro. Vlera: 1,200,000 lekë dhe 3,000 euro*”;
  - në DIPP-në e vitit 2010: “*Lekë të padepozituara (cash) nga të ardhurat e përfituara nga puna ime dhe e bashkëshortit. Vlera: 1,100,000 lekë*”;
  - në DIPP-në e vitit 2011: “*Të holla në cash, të padepozituara, nga puna ime dhe e bashkëshortit. Vlera: 1,700,000 lekë dhe 3,000 euro*”.

**11.1.1** Pas këtij deklarimi, subjekti dhe bashkëshortja nuk deklarojnë gjendje dhe as pakësime/shtesa të kursimeve *cash* në deklaratat vijuese.

**11.1.2** Komisioni konstaton se subjekti deklaron gjendje kursimesh *cash* në DIPP-në e viteve 2007 – 2011 dhe jo shtesa apo kursime të tyre.

**11.1.3** Pra, referuar këtyre deklarimeve, gjendja e kursimeve *cash* në datën 31.12.2016 ka qenë sa ajo e deklaruar në DIPP-në e viteve 2011, në vlerat 1,700,000 lekë dhe 3,000 euro (në total 2,114,900 lekë.)

**11.2** Subjekti, me anë të pyetësorit nr. 2, u pyet për mospërputhjen e gjendjes së kursimeve, e cila rezultonte nga deklaratimet periodike të viteve 2007 – 2016 me mosdeklarim të kursimeve *cash* në deklaratën *Vetting*, për të cilën sqaron: “*Në lidhje me shumatat e deklaruara si gjendje cash në*

*DIPP-në e vitit 2007 janë të ardhura të krijuara nga paga ime dhe puna e bashkëshortes sime për vitin 2007. Vlera prej 1,700,000 lekësh dhe 3,000 euro si gjendje cash në DIPP-në e vitit 2011 ka qenë gjendja cash në shtëpi në dhjetor të vitit 2011. Në vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015 nuk janë deklaruar shtesa dhe pakësime të gjendjes cash që prej vitit 2011, pasi kjo gjendje ka vazhduar të qëndrojë e pandryshuar. Në vitin 2016 është deklaruar shuma e shpenzuar në këtë vit dhe është shënuar diferenca në shumën prej 764,540 lekësh, si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të atij viti. Kjo diferencë përbënte edhe shumën cash të krijuar në vitin 2016. Në datën 23.1.2017 është depozituar në llogarinë e bashkëshortes sime pranë Credins Bank shuma 23,000 euro, e cila ishte pikërisht gjendja cash e deklaruar në vitin 2011 dhe shtesa e prej 764,540 lekësh e vitit 2016. Deklarata Vetting është dorëzuar në muajin shkurt 2017 dhe nuk kemi pasur gjendje cash për të deklaruar”.*

**11.2.1** Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar vlerë totale të të ardhurave neto të tij dhe bashkëshortes 2,264,540 lekë, ndërsa ka deklaruar edhe: “Gjithsej shpenzime, ku përfshihen: shpenzime për energji elektrike, ujë, tel., cel., internet, pushime, ushqim, karburant, siguracionet etj. Në vlerën 1,500,000 lekë. Diferenca 764,540 lekë”. Pas shpjegimeve të dhëna në pyetësonin nr. 2, diferenca 764,540 lekë, e cila rezulton nga totali familjar i të ardhurave neto minus shpenzimet gjithsej është përfshirë në gjendjen e kursimeve cash të vitit 2016.

**11.3** Gjithashtu, në lidhje me burimin e krijimit të gjendjeve të kursimeve cash të deklaruara nga subjekti dhe bashkëshortja, duke u mbështetur në analizën financiare të Komisionit, rezulton se në fund të vitit 2007 subjekti ka pasur pamundësi financiare për të krijuar gjendjen e kursimeve të deklaruara<sup>90</sup>, në vlerën -667,669 lekë dhe në vitin 2008 në vlerën 983,398 lekë.

**11.4** Ndërsa, në lidhje me mospërputhjen e gjendjes së deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 me deklaratën Vetting, e cila është trajtuar në pikën 5.6.13 më lart, si burim krijimi i depozitës së kursimit në euro pranë Credins Bank rezulton se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me dokumentacionin e përcjellë në Komision.

**11.5** Komisioni, gjatë hetimit të kësaj pasurie, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur pamundësi financiare në krijimin e gjendjes cash të kursimeve të deklaruara në DIPP-në e vitit 2007 në vlerën 667,669 lekë dhe në vitin 2008 në vlerën 983,398 lekë.

**Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.**

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**11.6** Komisioni, në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë seancës dëgjimore dhe me prapësime të cilat janë reflektuar më lart në vendim, si pjesë e analizës së burimit të krijimit të çdo pasurie, vlerëson se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pamundësi në vlerën 349,482 lekë në krijimin e gjendjes cash të vitit 2008. Ndërsa rezultati financiar i vitit 2007 pas rishikimeve të mësipërme është pozitiv.

---

<sup>90</sup> Vlerat 13,000 euro, 3,000 GBP dhe 4500 USD. Në total 2,443,525 lekë.

## **12. Depozitë kursimi e nënës së bashkëshortes, znj. P. P., pranë ProCredit Bank**

**12.1** Nga ProCredit<sup>91</sup> Bank rezulton se nëna e bashkëshortes, znj. P. P., ka çelur depozitë kursimi në datën 31.7.2004, duke derdhur *cash* shumën 200,000 lekë dhe në datën 9.11.2006 ka depozituar vlerën 12,600 lekë. Përgjatë periudhës 2004 – 2016, vlera e saj është rritur nga akumulimi i interesave të depozitës, të cilat nuk janë tërhequr prej znj. P. P., duke arritur vlerën 348,507.22 lekë, në datën 31.12.2016. Shuma e depozitës tërhiqet në datën 28.12.2018, kur vlera e saj ishte 351,487 lekë.

**12.2** Në lidhje me burimin e krijimit të saj, subjekti është pyetur me pyetësin nr. 2, për të cilën sqaron: *“Depozita e hapur nga nëna e bashkëshortes është krijuar nga të ardhurat e saj nga pensioni. Bashkëlidhur vërtetim nga ISSH Drejtoria Rajonale Elbasan nr. \*\*\*, datë 28.7.2023”*. Nga shkresa e ISSH-së, përcjellë me pyetësin nr. 2, rezulton se nëna e bashkëshortes ka përfutur pension pleqërie prej datës 1.4.1991.

**12.3** Komisioni hartoi analizën financiare të burimit të krijimit të vlerës 200,000 lekë, të depozituar nga nëna e bashkëshortes së subjektit për periudhën 1991 – 31.7.2004, nga ku rezultoi se ajo ka pasur pamundësi në krijimin me të ardhurat personale të saj nga pensioni i pleqërisë, në vlerën -105,599 lekë.

## **13. Në lidhje me fondin e pensionit të subjektit dhe bashkëshortes pranë Credins Invest**

**13.1** Credins Invest<sup>92</sup> sh.a. informon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij janë pjesë e fondit të pensionit prej gushtit të vitit 2015. Përkatësisht, z. Durim Bedini ka investuar në datën 7.8.2015 vlerën 1,000 lekë dhe në vijim investon këtë vlerë periodikisht çdo muaj, e në vazhdim. Në datën 31.12.2016, vlera e tij ishte 17,000 lekë, ndërsa znj. B. B. ka investuar për herë të parë vlerën 1,000 lekë, në datën 18.9.2015, deri në datën 1.12.2016, me vlerë totale investimi 14,000 lekë. Më pas, kjo vlerë rezulton të jetë tërhequr në total prej saj. Burimi i krijimit të fondeve të mësipërme të investimit për subjektin dhe bashkëshorten e tij janë gjendjet e llogarive rrjedhëse pranë Credins Bank.

**Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për mosdeklarimin e fondeve të investimit pranë Credins Bank.**

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**13.2** Subjekti, gjatë seancës dëgjimore, por edhe me prapësime, shpjegon se burimi i krijimit të fondeve të investimit janë gjendjet e llogarive rrjedhëse pranë Credins Bank. Në këtë kuptim, në kushtet kur llogaria rrjedhëse ka qenë e deklaruar, burimi i të ardhurave që ka shërbyer për këtë fond ka qenë i deklaruar dhe të gjitha veprimet janë kryer në këtë llogari, duke mos e konsideruar si veprim që duhej deklaruar më vete.

<sup>91</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, e ProCredit Bank.

<sup>92</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, e Credins Invest.

## **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**13.3** Komisioni i vlerësoi shteruese shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke e konsideruar mosdeklarimin e fondeve të pensionit si një pasaktësi të karakterit formal, jo të qëllimtë dhe, aq më tepër, me qëllim fshehjen e këtij investimi.

## **14. Në lidhje me llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në BKT**

**14.1** BKT-ja<sup>93</sup> informon se znj. B. B. (llogari individ) ka hapur llogari rrjedhëse në datën 29.9.2014. Kjo llogari, e cila vazhdon të jetë ende aktive, është përdorur kryesisht prej bashkëshortes së subjektit si llogari e lidhur me aktivitetin e saj të noterisë.

**Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për mosdeklarimin e llogarisë bankare pranë BKT-së të bashkëshortes në deklaratën *Vetting*.**

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**14.2** Subjekti gjatë seancës dëgjimore dhe me prapësimet shpjegon se kjo llogari rrjedhëse është hapur në datën 29.9.2014 nga bashkëshortja e tij, e cila është përdorur prej saj si llogari e lidhur me aktivitetin e noterisë. Në kushtet kur i përkiste veprimeve të aktivitetit të noterisë dhe të ardhurat dhe shpenzimet e këtij aktiviteti janë deklaruar çdo vit, duke përfshirë edhe të ardhurat që janë depozituar në këtë llogari si pagesë për kryerjen e veprimeve noteriale, nuk është kuptuar prej saj se duhej ta deklaronte këtë llogari.

## **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**14.3** Komisioni, në vijim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se ato janë shteruese. Kjo është një llogari bankare e lidhur me veprimtarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit si notere publike, llogari në të cilën janë pasqyruar pagesat përkatëse të kryera si nga klientë të ndryshëm që kanë kryer veprime noteriale pranë zyrës së saj, ashtu edhe nga veprime të ndryshme bankare të kryera nga vetë bashkëshortja e subjektit.

**14.4** Në përfundim, Komisioni i vlerësoi të mjaftueshme shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke e konsideruar mosdeklarimin e llogarisë bankare si një pasaktësi të karakterit formal, jo të qëllimtë dhe, aq më tepër, me qëllim fshehjen e transaksioneve të kryera në këtë llogari.

## **15. Analiza financiare e viteve 1995 – 2016**

**15.1** Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për rezultatin e analizës financiare të viteve 1995 – 2002 dhe 2003 – 2016, me vlerë negative 4,538,008 lekë.

**15.1.1** Ky rezultat financiar vjen si pasojë e: (a) në vitin 2004, me vlerë negative (2,814,660 lekë), e cila krijohet kryesisht për shkak të gjendjes së likuiditeteve të depozituara në sistemin bankar nga subjekti dhe bashkëshortja në këtë vit, specifikisht, depozitimi i vlerës 4,000,000 lekë pranë ProCredit bankës; (b) në vitin 2005, me vlerë negative (72,281 lekë), për shkak të depozitimit të vlerës 1,200,000 lekë pranë Raiffeisen Bank; (c) në vitin 2007, me vlerë negative (667,669 lekë);

---

<sup>93</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, e BKT-së.



(ç) në vitin 2008, me vlerë negative (983,398 lekë). Rezultati negativ në vitet 2007 dhe 2008 vjen kryesisht për shkak të gjendjes së kursimeve *cash* të deklaruar prej subjektit dhe bashkëshortes. **Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për rezultatin negativ të analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, e cila ka vlerën negative totale 4,538,008 lekë.**

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**15.2** Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe provat e depozituara prej tij, arriti në konkluzionin se ato kanë nivel besueshmërie dhe provueshmërie të mjaftueshëm. Këto vlerësime të Komisionit, të trajtuara gjerësisht më lart, u reflektuan në analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në vlerën 1,419,252 lekë, specifikisht në vitin 2004, vlera -1,069,770 lekë dhe në vitin 2008, vlera 349,482 lekë.

**15.3** Trupi gjykues, i udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit<sup>94</sup>, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, që kanë krijuar një pamundësi financiare, specifikisht në vitin 2004, vlera -1,069,770 lekë dhe në vitin 2008, vlera -349,482 lekë, nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë.

---

<sup>94</sup> Referojuni vendimeve nr. 31/2020 (JR) dhe nr. 18/2021 (JR) të Kolegjit.

## ANALIZA FINANCIARE 1995 – 2002

Vitet	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	Analiza financiare kumulative 1995-31.12.2002
<b>Të ARDHURAT</b>	<b>294,537 Lekë</b>	<b>304,725 Lekë</b>	<b>1,275,886 Lekë</b>	<b>593,567 Lekë</b>	<b>629,075 Lekë</b>	<b>755,774 Lekë</b>	<b>624,137 Lekë</b>	<b>617,198 Lekë</b>	<b>5,094,899 Lekë</b>
Të ardhura nga shitja e apartamentit në pronësi të subjektit			950,000 Lekë						950,000 Lekë
Te ardhura nga paga e subjektit të rivleresimit referuar vertetimeve të institucioneve	183,322 Lekë	172,488 Lekë	172,488 Lekë	410,971 Lekë	440,302 Lekë	502,909 Lekë	516,227 Lekë	523,334 Lekë	2,922,041 Lekë
Te ardhurat nga paga e bashkeshortes	79,385 Lekë	101,007 Lekë	108,398 Lekë	129,346 Lekë	129,973 Lekë	144,865 Lekë	6,978 Lekë		699,952 Lekë
Të ardhura të nënës së b/shortes nga pensioni	31,830 Lekë	31,230 Lekë	45,000 Lekë	53,250 Lekë	58,800 Lekë	108,000 Lekë	100,932 Lekë	93,864 Lekë	522,906 Lekë
<b>PASURI</b>	<b>- Lekë</b>	<b>- Lekë</b>	<b>- Lekë</b>	<b>- Lekë</b>	<b>- Lekë</b>	<b>- Lekë</b>	<b>- Lekë</b>	<b>- Lekë</b>	<b>- Lekë</b>
Blerja e apartament banimi me sip.57.9 m2 i ndodhur në L. ***, ***, **.									- Lekë
Automjeti tip BMW me targa *** përfituar me dhurim në vitin 2001.									
Ndryshimi i likuiditete në sistemin bankar									- Lekë
<b>SHPENZIMET</b>	<b>194,394 Lekë</b>	<b>201,119 Lekë</b>	<b>842,085 Lekë</b>	<b>517,154 Lekë</b>	<b>415,190 Lekë</b>	<b>216,000 Lekë</b>	<b>201,864 Lekë</b>	<b>256,879 Lekë</b>	<b>2,844,684 Lekë</b>
Shpenzime mobilimi deklaruar në pyetesor nr. 1								35,000 Lekë	35,000 Lekë
Shpenzime udhëtimi				125,400 Lekë				34,151 Lekë	159,551 Lekë
Shpenzime jetike për 3 anëtarë	194,394.42	201,119 Lekë	842,085 Lekë	391,754 Lekë	415,190 Lekë	216,000 Lekë	201,864 Lekë	187,728 Lekë	2,650,133 Lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>100,143</b>	<b>103,607</b>	<b>433,801</b>	<b>76,413</b>	<b>213,886</b>	<b>539,774</b>	<b>422,273</b>	<b>360,319</b>	<b>2,250,215</b>

## ANALIZA FINANCIARE 2003 – 2016

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>0</b>	<b>2,600,110</b>	<b>1,540,686</b>	<b>2,335,619</b>	<b>3,164,359</b>	<b>3,600,347</b>	<b>611,143</b>	<b>(21,390)</b>	<b>2,425,858</b>	<b>217,640</b>	<b>2,136,433</b>	<b>88,933</b>	<b>(178,477)</b>	<b>632,298</b>
Në posedim apartament me sipërfaqe 61 m <sup>2</sup> ndodhur në L.***, E***. Në bashkëpronësi të bashkëshortes me 1/3 pjesë, ndërsa nëna e saj 2/3 e pjesës takuese, sipas dëshmisë së trashëgimisë.														
Apartament banimi me sipërfaqe 57.9m <sup>2</sup> i ndodhur në L.***, i privatizuar bashkë me bashkëshorten në vitin 1993. Ky apartament është shitur në datë 12.5.1997 në vlerën 950,000 lekë.														
Automjet Daimler Chrysler C200, me targa *** i blerë datë 23.5.2013 në vlerën 1,000,000 lekë. Pjesa takuese 100%.											1,000,000			
Automjet me targa *** blerë me vlerë 5,800 euro dhe zhdogëni 293,089 lekë. Burim, të ardhurat nga puna dhe gjendja e ashpër të deklaruar në vitet më parë.						1,007,552								
Automjet targa *** blerë në dt. 10.11.2009 në vlerën 1,200,000 lekë me burim nga të ardhurat dhe gjendja e të hollave që disponoj cash (të padepozituara).							1,200,000							
Automjet Mercedes Benz me targa *** blerë në dt. 26.5.2010 në vlerën 125,000 lekë me burim të ardhurat nga puna.								125,000						
Bashkëshortja ka në pronësi automjet Mercedes A180 CDI i vitit 2006 me targa *** blerë në Gjermani në dt. 6.3.2013 në vlerën 6,300 euro dhe zhdogëni 180,300 lekë. Burimi i krijimit: (a) Të ardhurat nga puna (b) shpajti e mjeteve të mëparshme.											1,063,623			
Automjet Mercedes B180 CDI me targa *** i vitit 2005 blerë me datë 22.4.2011 në vlerën 3,700 euro + dogëna 440,000 lekë + transporti 1,500 euro. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat dhe gjendja që disponoj cash.									1,159,160					
Automjeti tip BMW me targa *** përfituar me dhurim në vitin 2001 dhe shitur me vlerë 400,000 lekë në vitin 2006.														
Shënim pakësimi e likuiditetit në bankë dhe CASH		2,600,110	1,540,686	2,335,619	3,164,359	2,592,796	-588,857	-146,390	1,266,698	217,640	72,810	88,933	-178,477	632,298
<b>Totali shprehur në</b>	<b>1,599,990</b>	<b>4,200,000</b>	<b>5,740,636</b>	<b>8,076,303</b>	<b>11,240,664</b>	<b>13,833,439</b>	<b>13,244,602</b>	<b>13,093,212</b>	<b>14,364,910</b>	<b>14,532,550</b>	<b>14,653,360</b>	<b>14,744,293</b>	<b>14,565,817</b>	<b>15,198,113</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>480</b>	<b>2,179</b>	<b>4,067</b>	<b>6,431</b>
Kartë krediti bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit											480	2,179	4,067	6,431
<b>PASURI NETO</b>	<b>0</b>	<b>2,600,110</b>	<b>1,540,686</b>	<b>2,335,619</b>	<b>3,164,359</b>	<b>3,600,347</b>	<b>611,143</b>	<b>(21,390)</b>	<b>2,425,858</b>	<b>217,640</b>	<b>2,135,953</b>	<b>86,754</b>	<b>(182,543)</b>	<b>625,868</b>
<b>TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>1,881,782</b>	<b>2,323,712</b>	<b>3,185,964</b>	<b>4,505,712</b>	<b>4,538,546</b>	<b>4,165,773</b>	<b>3,370,207</b>	<b>2,826,506</b>	<b>4,910,284</b>	<b>3,054,362</b>	<b>5,205,019</b>	<b>4,266,621</b>	<b>4,538,443</b>	<b>2,468,467</b>
Të ardhura të subjektit nga puna e subjektit të rivlerësimit	784,953	1,216,048	1,235,705	1,197,335	1,311,839	1,130,546	1,202,136	1,428,434	1,428,424	1,505,438	1,122,992	1,335,025	1,304,984	1,383,136
Të ardhurat të bashkëshortes nga aktiviteti i noterit publik	1,000,000	1,000,000	1,544,054	2,747,500	2,747,644	2,431,289	1,721,646	992,269	1,247,049	1,220,387	2,166,354	2,702,157	3,024,368	883,290
Të ardhura të nënës së bashkëshortes nga pensioni	96,829	107,664	119,029	126,888	132,720	141,984	155,620	162,282	99,836	174,690	180,665	186,017	189,314	192,034
Të ardhura nga shpajti e automjetit Mercedes Benz me targa ***, cunimi i shpajtit 300,000 lekë								125,000						
Të ardhura nga shpajti e automjetit Mercedes Benz Mercedes E220 me targa *** në vlerën 10,500 euro - 1,452,150 lekë									1,200,000					
Të ardhura nga shpajti e automjetit me targa *** në dt. 23.3.2013 në vlerën 3,000 euro											420,630			
Të ardhura nga shpajti e automjetit Mercedes B180 CDI me targa *** në dt. 28.2.2013 në vlerën 1,200,000 lekë											1,200,000			
Të ardhura nga shpajti e automjetit BMW me targa *** shitur me vlerë 400,000 lekë në vitin 2006				400,000										
Të ardhura nga depozitat bankare pranë R.*** bank bashkëshortja			44,626		42,362	1,976				58,272	43,253	3,445	2,187	109
Të ardhura nga depozitat bankare pranë P.*** bank bashkëshortja			229,950		191,872	292,805	155,567							
Të ardhura nga depozitat bankare pranë P.*** bank vjetra			12,600	10,524	9,639	12,604	17,666	17,735	15,921	15,239	15,143	14,719	5,811	5,029
Të ardhura nga interesat e depozitave të kursimit pranë C.*** bank bashkëshortja				23,465	102,451	154,570	117,572	100,772	80,524	80,236	55,981	25,259	11,780	4,868
Këmbim huaje nga shtetasja B.*** G.***							272,880							
<b>SHPEZIME</b>	<b>281,892</b>	<b>793,372</b>	<b>1,377,558</b>	<b>1,042,428</b>	<b>1,073,222</b>	<b>914,908</b>	<b>900,000</b>	<b>1,048,386</b>	<b>624,225</b>	<b>1,400,000</b>	<b>1,700,000</b>	<b>2,000,000</b>	<b>2,000,000</b>	<b>1,500,000</b>
Shpenzime të deklaruar në deklarata periodike							252,836			296,175	651,613	1,213,907	1,079,402	396,549
Shpenzime në obilimi dhe arretimi i deklaruar në pyetësor nr.1		258,000	1,016,819		200,000					363,000	415,000			60,000
Shpenzime udhëtimi		253,480	32,068	713,757	463,362	505,048	237,304	638,526	214,365	322,181	210,315	12,6099	247,770	338,175
Shpenzime për 3 anëtarë	281,892	281,892	328,671	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	409,860	418,644	423,072	659,994	672,828	705,276
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>1,599,990</b>	<b>(1,069,770)</b>	<b>267,719</b>	<b>1,127,665</b>	<b>300,966</b>	<b>(349,482)</b>	<b>1,859,064</b>	<b>1,799,510</b>	<b>1,860,200</b>	<b>1,436,722</b>	<b>1,369,066</b>	<b>2,179,867</b>	<b>2,720,987</b>	<b>342,599</b>

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**16.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2023, ka dërguar pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit Durim Bedini, deklasifikuar plotësisht (me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.7.2023, të KDZH-së) dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

i) Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.

ii) Për subjektin e rivlerësimit Durim Bedini nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar.

*Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Durim Bedini.*

**Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke u dakordësuar me konstatimin e Grupit të Punës për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Durim Bedini.**

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**17.** Rivlerësimi profesional sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është i bazuar në raportin e përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2018, për subjektin e rivlerësimit Durim Bedini.

### **17.1 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:**

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme;
- kriteret e vlerësimit, të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

### **17.2 Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit**

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit konstatohet se formulari i vetëdeklarimit paraqitet i nënshkruar nga subjekti, por i paplotësuar në pjesën e trajnimeve e pa shpjegime lidhur me pjesëmarrjen në trajnime.

### **17.3 Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**a) Vendim për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\***, që i përket veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Vendimi është i qartë dhe i kuptueshëm dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë bërë ankim nga palët.

**b) Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\***, që i përket veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal<sup>95</sup>. Edhe nga drejtuesi i Prokurorisë për këtë procedim është dhënë opinioni për mosfillim të procedimit penal. Ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim nga palët.

**c) Kërkesë për gjykimin e çështjes të procedimit penal nr. \*\*\***, që i përket të pandehurit R. H., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal<sup>96</sup>. Pas përfundimit të hetimeve nga subjekti është përpiluar akti “Kërkesë për gjykim”, akt i qartë dhe i kuptueshëm, dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit.

**Komisioni arrin në përfundimin se bazuar në raportin e KLP-së, por edhe nga analiza e kryer nga vetë Komisioni, nuk u konstatuan problematika lidhur me kriterin profesional në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit.**

### **17.4 Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura me short**

**Dosja 1** – Vendim “Mosfillimi i procedimit penal” të kallëzimit nr. \*\*\*, që i referohet materialeve të referuara nga Komisariati i Policisë Kavajë, në ngarkim të personit të dyshuar J. Xh., për veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal. Vendimi është i qartë dhe i kuptueshëm dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim nga palët.

**Dosja 3** – Vendim i pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, referuar veprës penale “Lidhja e paligjshme e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, në ngarkim të personit nën hetim L. Xh., nga materialet e referuara nga Komisariati i Policisë Kavajë.

Konstatohet se, në rastin konkret, trajtimi i bërë në argumentimin e vendimit ka qenë në përshtatje me kushtet e rënda shëndetësore dhe mjekësore të të dyshuarit. Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë bërë ankim në gjykatë.

**Dosja 4** – Dokumenti “Kërkesë për dërgimin në gjyq” të procedimit penal nr. \*\*\*, për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. B.

Kërkesa për gjykim është e strukturuar sipas procedurës. Në të parashtrohet fakti penal i ndodhur, burimet, provat etj.

---

<sup>95</sup> Që i përket kallëzimit penal të shtetasit F. M. ndaj prokurores së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë E. A., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.

<sup>96</sup> Ky procedim i referohet çështjes, ku nga shërbimet policore dhe task-forca e OSHEE-së është ushtruar kontroll në ambientet e lokalit “Kazino” në Kavajë, në administrim të shtetasit R. H. dhe nga kontrolli i ushtruar matësit të energjisë elektrike është konstatuar cenim i vulave dhe lidhje e paligjshme e energjisë.

**Dosja 5** – Procedimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit S. T., dërguar për gjykim. Në konkluzionet përfundimtare, subjekti ka kërkuar: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit S. T. për kryerjen e veprës penale “Kundërshtimi me dhunë i punonjësve të policisë së rendit publik” dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim. Të aplikohet neni 406 i Kodit të Procedurës Penale mbi këtë masë dënimi”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2014, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit S. T. për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik” dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit Penal dënimin e tij me 6 muaj burgim”*. Ndaj vendimit të Gjykatës nuk është ushtruar ankim nga palët, duke marrë formë të prerë.

**Komisioni vëren se bazuar në raportin e KLP-së, si dhe nga analizimi i dokumentacionit ligjor përkatës nga ana e vetë Komisionit, nuk u konstatuan problematika lidhur me kriterin profesional në dosjet 1, 3, 4 dhe 5, të përzgjedhura me short.**

**Dosja 2** – Vendim “Pushimi i procedimi penal nr. \*\*\*/2014”, për veprën penale “Mosbindja ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. M., regjistruar në bazë të akteve të referuara nga Komisariati i Policisë Kavajë<sup>97</sup>.

Nga analizimi i akteve në dosje nga Komisioni dhe KLP-ja është konstatuar:

a) *Vendimi i pushimit nuk është i argumentuar drejt dhe nuk është bazuar në akte dhe prova të plota e të pakundërshtueshme, pasi ishte e nevojshme të kryheshin edhe veprime të tjera për të arritur në një konkluzion kategorik nëse ishin konsumuar apo jo elementet e kundërvajtjes penale “Mosbindja ndaj urdhrin të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal.*

b) *Vendimi i pushimit gjatë argumentimit të tij konstatohet me gabime, si dhe pasaktësi të ndryshme, duke referuar momente pa u kushtuar rëndësinë e duhur. Kështu, gjatë hetimit është përmendur shtetasi A. M., duke drejtuar automjetin e tij fuoristradë me targë \*\*\*, kur në fakt ai po drejtonte mjetin autoveturë tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\*, ndërsa mjeti i parë ishte ai me të cilin erdhën shokët e tij e u largua i dyshuari.*

c) *Në arsyetimin e vendimit të pushimit, prokurori është mbështetur në relacionin e OPGJ-së, i cili në vetvete konstatohet se nuk është përpiluar pas kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore dhe konkretisht:*

*Nga kallëzimi, deklaratimet dhe raporti i shërbimit të oficerit të policisë rrugore G. B. nuk pasqyrohet asnjë justifikim se përse shtetasi A. M. ka kryer shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, por, përkundrazi, pas disa hezitimesh, për të mos i dhënë dokumentacionin, tregohen edhe momente ku përveç mosbindjes të kishte edhe tendenca të kundërshtimit me forcë të tij.*

---

<sup>97</sup> Për detaje shihni dosjen nr. 2 në dosjen e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, përcjellë nga KLP-ja.

*Në aktet e fashikullit penal, përveç veprimeve për kthimin e automjetit të sekuestruar, të cilin e kishte lënë në rrugë shtetasi A. M., nuk është kryer asnjë veprim për verifikimin e pretendimeve të ngritura në kallëzim dhe në raportin e shërbimit, mbajtur nga oficeri i policisë rrugore.*

**17.5** Nga hetimi administrativ, për sa është konstatuar më lart, evidentohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të thelluara hetimore në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale për të arritur në konkluzionin e vendimi të pushimit të procedimit penal. Për konstatimin e mësipërm, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**17.6** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, ndër të tjera<sup>98</sup>, ka shpjeguar: “[...] punonjësi i policisë ka kërkuar dokumentacionin e automjetit, të cilin shtetasi A. M. ia ka dhënë, ku është konstatuar se mungonte dokumentacioni i kontrollit teknik të mjetit. Në këto kushte, punonjësi i policisë duhet të kishte vijuar me marrjen e masës administrative për shkëljen e konstatuar. [...] Mosbindja e urdhrin të punonjësit të policisë do të ishte në rast se automjeti nuk do të kishte respektuar shenjë e ndalimit dhe personi nuk do kishte pranuar të identifikohet. Mungesa e një dokumenti nuk e ngarkon me përgjegjësi penale sipas nenit 242 të Kodit Penal, por me përgjegjësi administrative sipas dispozitave të Kodit Rrugor. Në rastin konkret, qëllimi i tij nuk ka qenë pengimi i punonjësve të policisë në ushtrimin e detyrës dhe mosdorëzimi i dokumentit të kontrollit teknik nuk është bërë me qëllim për të refuzuar urdhrin, por sepse nuk e dispononte atë. Sa më sipër, kur nga analizimi i elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal me provat dhe rrethanat e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2014, është arritur në konkluzionin se nuk plotësohen në mënyrë kumulative të katër elementet e domosdoshme të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal dhe procedimi penal është pushuar.

*Bazuar ky përfundim në faktin se vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjitha elementeve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementet e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive.*

*Verifikimi më tej nëse shtetasi A. M. kishte pasur ose jo realisht një fatkeqësi familjare, nuk do të çonte në ndonjë përfundim të ndryshëm në lidhje me këtë procedim penal”.*

**17.7** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për sa është konstatuar më lart. Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte shpjeguar me detaje në lidhje me gabimet e konstatuara në vendimin e pushimit të procedimit. Nuk ka shpjeguar për konstatimin e vendimi i pushimit është bazuar në relacionin e OPGJ-së përpara se të kryhen të gjitha veprimet e tjera hetimore dhe në vendim nuk janë përfshirë veprimet e fundit hetimore. Nuk janë ballafaquar thëniet e oficerit të policisë dhe personit ndaj të cilit referohet vepra penale. Pra, në thelb, nuk janë kryer veprime të thella hetimore në përputhje me nenin 24 e Kodit të Procedurës Penale, për të arritur në konkluzionin e vendimit të pushimit.

**Komisioni vëren se në lidhje me këtë procedim penal subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të plota hetimore në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, por kjo**

---

<sup>98</sup> Shihni me detaje prapësimet e subjektit në dosje.

**mangësi vlerësohet se nuk arrin deri në atë masë sa ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin profesional, në përputhje me pikën 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.**

## **17.8 Të dhëna nga burime arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme**

**17.8.1** Sipas të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme, subjekti Durim Bedini është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm, si vijon:

- për vitin 2013 është vlerësuar “shumë mirë”;
- për vitin 2014 është vlerësuar “mirë”;
- për vitin 2015 është vlerësuar “shumë mirë”;
- për vitin 2016 është vlerësuar “mjaftueshëm”.

**17.8.2** Komisioni, referuar vlerësimit “mirë” të vitit 2014 dhe “mjaftueshëm” të vitit 2016, nga Prokurori i Përgjithshëm, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime se cilat kanë qenë arsyet që kanë çuar në një vlerësim të tillë, duke e shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës. Për këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**17.8.3** Subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar se dy vlerësimet e bëra nga Prokurori i Përgjithshëm i asaj kohe nuk janë bërë në bazë vlerësimi pune, por ka qenë një vlerësim personal, për shkak të kontradiktave që kishte pasur ai me drejtuesin, Prokurorin e Përgjithshëm. Subjekti, ndër të tjera, shpjegon se ankimimi i masës disiplinore i vitit 2016 nuk është bërë nga ana e tij, për arsye se kjo masë i është komunikuar me shumë vonesë dhe se ajo tashmë e kishte humbur fuqinë dhe pasoja të tjera që mund të sillte.

✓ Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova mbi kundërshtimet që ai mund t’u ketë bërë këtyre masave disiplinore, por, nga ana tjetër, i ka konsideruar të mjaftueshme shpjegimet e dhëna nga vetë subjekti, duke mbajtur gjithashtu në konsideratë faktin që organi kontrollues, Prokuroria e Përgjithshme, nuk depozitoi dokumentacion provues për të vërtetuar vlerësimin “mirë” për vitin 2014 dhe “mjaftueshëm” për vitin 2016, bashkë me dosjen profesionale të subjektit të rivlerësimit Durim Bedini, dërguar Komisionit për vlerësimin profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit.

**17.9** Në raportin e KLP-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar aftësi të mira për sa i përket aftësive organizative<sup>99</sup>, etikës dhe angazhimit profesional<sup>100</sup>, si dhe aftësive personale dhe angazhimit profesional<sup>101</sup>.

**17.9.1** Ndërsa, për sa i përket *aftësive profesionale*, ku përfshihen njohuritë ligjore, u gjetën edhe raste kur zgjidhjet e procedimeve penale kanë qenë të pambështetura në prova të plota, zgjidhja e të cilave nuk gjen bazën e duhur ligjore në të cilën është mbështetur prokurori. Ndërsa, për sa i përket *arsyetimit ligjor*, vendimet, kërkesat dhe aktet e tjera të përpiluara prej tij përgjithësisht janë

<sup>99</sup> Ku përfshihen: aftësia për të përballuar ngarkesën në punë; aftësia për të administruar dosjet.

<sup>100</sup> Ku përfshihen: integriteti; paanësia.

<sup>101</sup> Ku përfshihen: aftësia e komunikimit; aftësia për të bashkëpunuar; gatishmëria për t’u angazhuar.



të qarta dhe të kuptueshme, por u konstatuan edhe raste kur nuk përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

## **17.10 Të dhëna nga prokuroritë**

**17.10.1 Prokuroritë e rretheve gjyqësore**<sup>102</sup> kanë konfirmuar se pranë tyre nuk rezulton të ketë procedime penale të mosfilluara/pushuara/pezulluara apo të dërguara për gjykim për subjektin e rivlerësimit Durim Bedini.

**17.10.2 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë**<sup>103</sup> konfirmon se në datën 14.11.2016 është regjistruar kallëzimi penal i shtetasit F. M., ndaj subjektit Durim Bedini, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” dhe “Përkrashja e autorit të krimit”, të parashikuara nga nenet 248, 301 dhe 302/1 të Kodit Penal. Ky kallëzim është hetuar nga prokurori M. S. dhe në përfundim të hetimit është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”. Ndaj këtij vendimi nuk është bërë ankim në gjykatë.

**17.10.3 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë**<sup>104</sup> konfirmon se në datën 18.5.2017 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të subjektit Durim Bedini dhe 4 prokurorëve të tjerë (kur subjekti ka qenë me detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Elbasan). Për këtë procedim, në datën 1.6.2017 është vendosur pushimi i hetimeve, vendim i cili është në fuqi.

## **17.11 Të dhëna nga sektori i protokoll-arkivit**

Nga verifikimi i ushtruar në regjistrat e ankesave për periudhën 2006 – 2018 rezultojnë tri ankesa, të cilat janë analizuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe u është kthyer përgjigje<sup>105</sup>.

**17.12 Denoncimet/ankesat nga publiku** – Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 4 denoncime/ankesa nga publiku.

### **17.12.1 Në lidhje me denoncimet/ankesat e mëposhtme:**

**a) Denoncimi/ankesa nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2018**, të shtetasit A. C., i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit Durim Bedini dhe disa subjekte të tjera rivlerësimi kanë kryer veprime korruptive për dosjet e tij, të cilat janë të arkivuara në Prokurorinë e Rrethit Elbasan. Denoncuesi ka bashkëngjitur disa dokumente pronësie, korrespondenca që ka bërë me institucione të ndryshme për probleme pronësie, si dhe i referohet procedimit penal nr. \*\*\*/2014. Komisioni ka administruar fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\*/2014 nga Prokuroria

<sup>102</sup> Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Gjirokastrë, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Berat, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Korçë, me nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021; Kurbin, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Elbasan, me nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021; Krujë, me nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021; Lezhë, me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Fier, me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Vlorë, me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Dibër, me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2020; Pogradec, me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Sarandë, me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Kukës, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Mat, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Durrës me nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Kavajë me nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2021; Shkodër me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Pukë, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Përmet, me nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021.

<sup>103</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

<sup>104</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2018, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë (shkresë dërguar Prokurorisë së Përgjithshme).

<sup>105</sup> Praktika nr. \*\*\*, viti 2016, e shtetasit F. M., që është edhe kallëzuesi i çështjes së hetuar nga Prokuroria e Rrethit Lushnjë dhe praktikat nr. \*\*\*/2007 dhe nr. \*\*\*/2007 të shtetasit F. H.

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan<sup>106</sup>, ku rezulton se kallëzimi i shtetasit A. C., për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, është hetuar nga prokurorët E. M., K. A. dhe F. L., i cili në përfundim të hetimeve ka vendosur pushimin e hetimeve, pasi nuk u konstatuan veprime në kundërshtim me ligjin nga punonjësit e ZVRPP-së Elbasan për regjistrimin e pronës në favor të shtetasit I. T. Nuk rezultoi që kjo çështje të jetë hetuar edhe nga prokurori Durim Bedini.

**b) Denoncimi/ankesa nr. \*\*\* prot., datë 19.8.2019, nr. \*\*\* prot., datë 27.11.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.3.2020**, të shtetasit V. T., i cili pretendon se subjekti Durim Bedini, gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë të tjerë, kanë bërë korrupsion në lidhje me dënimin e tij për dhunë në familje. Për subjektin Durim Bedini, në denoncimet e tij nuk parashtron ndonjë shkelje konkrete. Ai ka bashkëngjitur vendimin e mosfillimit të procedimit penal të vitit 2019, për një kallëzim të bërë ndaj avokatit I. K., i cili ka nënshkruar disa akte hetimore të mbajtura në Komisariatin e Policisë Kavajë kundër tij. Kallëzimi i tij është mosfilluar nga prokurori Durim Bedini, pasi nuk provohet se ndodhemi përpara ndonjë vepre penale, pasi veprimet e arrestimit në flagrancë të tij janë bërë në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht I. K.

**c) Denoncimi/ankesa nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2018**, i shtetasit J. M., i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit për kallëzimin e bërë prej tij nuk e ka thirrur ndonjëherë dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Denoncuesi ka bashkëngjitur vendimin e mosfillimit të vitit 2018, të marrë nga subjekti Durim Bedini, i cili ka argumentuar se nuk ka elemente të ndonjë vepre penale në kallëzimin e bërë. Sipas vendimit të mosfillimit të vitit 2015, të depozituar po nga vetë denoncuesi, më herët në vitin 2015 denoncuesi ka bërë të njëjtin kallëzim, i cili është mosfilluar nga prokurori që e ka hetuar, me argumentin se nuk ka elemente të ndonjë vepre penale. Denoncuesi i është drejtuar në vitin 2015 Prokurorisë së Përgjithshme me ankesë kundër vendimit të mosfillimit të vitit 2015, por nga kjo Prokurori pas verifikimit është konkluduar se vendimi i mosfillimit i vitit 2015 ka qenë i bazuar në ligj dhe në prova dhe nuk ka shkaqe për shfuqizimin e tij.

**ç) Denoncimi/ankesa nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2018**, e shtetasës Sh. M., e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit Durim Bedini dhe disa gjyqtarë të tjerë kanë dhënë vendim të padrejtë në dënimin me burgim të përjetshëm të djalit të saj dënuar për vrasje. Denoncuesi ka bashkëngjitur vendimin e vitit 2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku rezulton i dënuar djali i saj për vrasje. Për subjektin e rivlerësimit Durim Bedini nuk ka referuar ndonjë të dhënë konkrete.

✓ **Komisioni vëren se denoncimet e lartpërmendura nuk plotësojnë kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi denoncuesit nuk kanë referuar rrethana konkrete, praktika apo veprime specifike, që të krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.**

---

<sup>106</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, drejtuar Komisionit.

**17.12.2** Për denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2019, të shtetasit P. I., i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit Durim Bedini si prokuror i çështjes për kallëzimin e tij të bërë që në vitin 2016 dhe deri nga viti 2019 nuk ka përfunduar ende hetimet, duke e zvarritur çështjen me 2 vjet e gjysmë.

**17.12.2.1** Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni ka administruar dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*/2016 të ish-Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë<sup>107</sup>, për kallëzimin e shtetasit P. I., për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe administratorit E. Rr. Nga aktet e dosjes rezulton se kallëzimi penal i shtetasit P. I. është regjistruar pranë ish-Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë me datë 15.9.2016 dhe çështja i ishte caktuar për hetim prokurorit Durim Bedini. Prokurori Durim Bedini ka kryer veprime hetimore gjatë kësaj kohe deri në datën 27.7.2017, kur nga ana e tij është marrë vendim për pezullimin e hetimeve për shkak se në datën 24.7.2017 nga drejtuesi i kësaj Prokurorie A. M. i është drejtuar shkresë Ministrisë së Drejtësisë, që kjo e fundit t’i drejtohet Ministrisë së Sigurisë në Holandë për të sjellë informacionin e kërkuar për çështjen në fjalë. Me kthimin e përgjigjes datë 13.7.2018 nga autoritetet holandeze, për informacionin e kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Kavajë, subjekti Durim Bedini, në datën 1.5.2019 ka vendosur rifillimin e hetimeve ku ka kryer një seri veprimesh hetimore gjatë kësaj kohe. Në datën 15.12.2019, subjekti Durim Bedini ka vendosur përfundimin e hetimeve dhe marrjen si të pandehur të shtetasit E. Rr., për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe në datën 30.12.2019 ka dërguar çështje për gjykimin e të pandehurit në fjalë.

**17.12.3** Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit në fashikullin penal, ka konstatuar se:

- i) Vendimi i pezullimit të hetimeve nuk është marrë në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, ku në paragrafin e parë përcakton rastet e pezullimit: *“Kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë, që ndalon hetimin e mëtejshëm”*.
- ii) Konstatohet se vendimi për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit autoteknik, i datës 13.5.2019, i përpiluar nga subjekti Durim Bedini, nuk rezulton t’i jetë njoftuar palëve të interesuara në bazë të nenit 179 “Caktimi i ekspertit”, ashtu siç përcaktohet edhe në vetë vendimin e prokurorit Durim Bedini.
- iii) Vendimi i pezullimit të hetimeve, datë 27.7.2017, i prokurorit Durim Bedini, nuk rezulton t’i jetë komunikuar viktimës ose personit që ka bërë kallëzimin, në rastin konkret shtetasit P. I., ashtu siç parashikohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale.

**Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.**

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**17.13** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se është e vërtetë se nuk ka pasur person nën hetim në mënyrë që të bëhej pezullimi i çështjes në përputhje me procedurën, por fakti që pritej një përgjigje letërporsie nga jashtë shtetit kërkon një kohë të konsiderueshme. Kjo ka qenë praktika që

---

<sup>107</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, drejtuar Komisionit.

aplikohej në të gjitha prokuroritë dhe me ardhjen e kësaj letërporosie janë përfunduar hetimet dhe çështja është dërguar në gjyq.

**17.14** Meqenëse nuk ka pasur person nën hetim, nuk i është komunikuar vendimi i kryerjes së aktit të ekspertimit, si edhe vendimi i pezullimit të çështjes.

**17.15** Nuk ka pasur vendimmarrje gjykate për pavlefshmëri apo papërdorshmëri të veprimeve procedurale të kryera nga subjekti, i cili ka kërkuar fajësi dhe personi është deklaruar fajtor nga gjykata.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**17.16** Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme. Komisioni ka konstatuar se në rastin e pezullimit të çështjes, edhe pse në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet pezullimi për shkak të vonesës së ardhjes së letërporosisë nga një vend i huaj, e cila është e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, subjekti ka vepruar që për “ekonomi hetimore” të pezullojë çështjen derisa të vijë letërporosia nga ai vend i huaj, në vend që ta pushojë atë, pasi do kishte kosto kohore në hapjen e saj nga e para dhe në kryerjen e veprimeve hetimore nga fillimi. Pezullimi dhe të gjitha veprimet e tjera procedurale janë gjetur të bazuara nga gjykata, e cila ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke e marrë personin në fjalë si të pandehur, i cili më pas është dënuar nga gjykata.

**Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit i gjeti të mjaftueshme dhe të bazuara, si dhe nuk konstaton problematika në lidhje me çështjen objekt denoncimi.**

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Durim Bedini:

- a) Ka kryer në tërësi deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive, duke rezultuar me një pamundësi financiare, specifikisht në vitin 2004, vlera -1,069,770 lekë dhe në vitin 2008, vlera 349,482 lekë, ku në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit<sup>108</sup>, vlerëson se kjo mungesë e burimeve të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë.
- b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

---

<sup>108</sup> Referojuni vendimeve nr. 31/2020 (JR) dhe nr. 18/2021 (JR) të Kolegjit.

- c) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Durim Bedini, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 20.10.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*